



*SOS Fshatrat e Fëmijëve
Shqipëri*

Të rinjtë pa kujdes prindëror Praktika, legjislacioni dhe të drejtat



**Të rinjtë pa kujdes prindëror në Shqipëri
Praktika, legjislacioni dhe të drejtat**

Autorë:

**Mirela Muca & Vilma Kolpeja
(Qendra Kombëtare Shqiptare për Studime Sociale)**

**Almandina Guma, Alketa Berzani, Elsa Osmani
(SOS Fshatrat e Fëmijëve, Shqipëri)**

Botim i organizatës “SOS Fshatrat e Fëmijëve”

Tetor, 2009

RRETH ORGANIZATËS “SOS FSHATRAT E FËMIJËVE”

SOS Fshatrat e Fëmijëve është një organizatë sociale, jofitimprurëse, misioni i së cilës është në shërbim të fëmijëve pa kujdes prindëror apo në rrezik për ta humbur atë.

Programet kryesore të organizatës SOS Fshatrat e Fëmijëve janë:

- SOS Fshati i përbërë nga 13 shtëpi pritëse për fëmijët të cilët e kanë humbur kujdesin prindëror.
- SOS Komunitetet Rinore që ofrojnë përkujdesje për fëmijët pa kujdes prindëror mbi moshën 14 vjeç. Të rinjtë mbështeten dhe aftësohen për jetën e tyre si të rritur nëpërmjet programeve të gjysëmpavarësisë dhe pavarësisë së plotë.
- Projektet e Fuqizimit të Familjes të shtrira në Shkodër dhe Tiranë që mbështesin fëmijët të cilët përballen me rrezikun e humbjes së përkujdesjes së familjes së tyre. Shërbimet e ofruara konsistojnë në sigurimin e të drejtës së mbijetesës, zhvillimit dhe pjesëmarrjes së fëmijëve si dhe shërbime për rritje të kapaciteteve prindërore.
- SOS shkolla dhe kopshti që ofrojnë programe edukative për më shumë se 400 fëmijë të Fshatit SOS, Tiranës dhe komunitetit përreth. Edukimi i fëmijëve me nevoja të veçanta, vulnerabël dhe nga familje me risk është pjesë domethënëse e punës në SOS Shkollë dhe SOS kopsht.

Falenderim

Të dhënat e këtij studimi u realizuan me kontributin e çmuar të disa bashkëpunëtorëve që operojnë në fushën e rinisë dhe veçanërisht në drejtim të shërbimeve për të rinjtë pa kujdes prindëror.

Rekomandimet e këtij raporti janë përpunuar në përputhje me kontributin e dhënë nga aktorët që punojnë për të rinjtë pa kujdes prindëror

Falenderojmë për realizimin e këtij studimi, Z. Nexhmedin Dumani, Ministria e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Z. Mihal Naço, Shërbimi Social Shtetëror, Z. Përparim Shera, Ministria e Arsimit, Zj. Iva Zajmi dhe Zj. Irena Taga, Ministria e Brendshme, Zj. Floriana Hima, UNICEF, Zj. Gladiola Musabelliu, Bashkia Tiranë, Z. Ridvan Troshani, Bashkia Shkodër, Z. Ilir Çumani, Instituti Kombëtar I Jetimëve, Znj. Lida Leskaj, Z. Berti Stratobërdha, Bashkia Korçë, Zj. Anila Nepravishta, Avokati I Popullit, Znj. Lida Leskaj, ISS, Z. Përparim Demçellari, Qendra Tag, Z. Arjan Emmini dhe Zj. Ersila Korina, Shtëpia e Shpresës Elbasan, Z. Teit Tabaku, Tjetër Vizion Elbasan, Z. Slavka Cekuta, Orët Fatlume Elbasan, Z. Fabrizio Nocchi dhe Zj. Diana Lekaj, Maddonina Del Grappa, Zj. Edlira Bashmili, Terre Des Homes, Zj. Adriana Neli, Konvikti i vajzave “Safet Spahiu”, Shkodër, Z. Arben Zuna, Konvikti i Hoteleri Turizëm, Tiranë, Z. Leonard Guni, Fëmijët e Botës dhe të Shqipërisë, Tiranë, Z. Natassa Arapidou, Arsis Tiranë, Zj. Enkelejda Medha, Zyber Hallulli Tiranë, Z. Besnik Kolgjini dhe Zj. Pranvera Dizdari.

Në mënyrë të veçantë falenderojmë të rinjtë Tiranë, Shkodër dhe Elbasan të cilët sollën këndvështrimin e tyre në këtë studim, Edmondin, Elidjana, Juli, Diana, Arlinda, Fresnis, Arjana, Ardita, Laureta, Majlinda, Donieta, Florida, Esteri, Bedrie, Xhesi, Thelleza, Erzeni, Klodi, Mjaftonia, Fatjoni, Lindita.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

HYRJE

**Përshkrimi i ekipit të studimit
Metodologjia
Konsultimi me aktorët**

TË DHËNA PËR SHQIPËRINË

LEGJISLACIONI SHQIPTAR

**Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve
Të rinjtë pa kujdes prindëror
Strukturat për të rinjtë 15-24 vjeç
Strukturat për të rinjtë me vështirësi zhvillimore
Përgatitja për jetesën e pavarur
Shërbime pas përkujdesjes**

PROFILI I TË RINJVE PA KUJDES PRINDËROR

Të dhëna për të rinjtë pa kujdes prindëror

SITUATA E TË DREJTAVE PËR TË RINJTË

Mosdiskriminimi

**Arsimi
Punësimi
Strehimi
Mbrojtja
Shëndeti
Mbështetja
Pjesëmarrja
Interesi më i lartë
Koha e lirë**

PËRGJEGJËSI DHE SFIDA TË AKTORËVE

KOMENTE DHE REKOMANDIME

**Bibliografi
Lista e institucioneve
Shkurtime
Fjalorth**

Shqipëria në krahasim me shtetet e tjera, përfshirë edhe vendet e rajonit, ka një numër të vogël të rinjsh që lenë përkujdesin social, (62,4 për çdo 100 mijë të grupmoshës 0-17 vjeç¹). Megjithë numrin e vogël, kjo kategori ndan experienca nga më të veshtirat, ata vuajnë diskriminim dhe disavantazhe të shumta. Shumë prej tyre kanë nivel të ulët arsimor dhe mbeten të papunë për një periudhë të gjatë kohe, pjesa me e madhe janë të pa strehë dhe në risk për tu përfshirë në aktivitete kriminale apo për të qenë objekt i keqbërësve dhe trafikantëve ndërkohë që një perqindje jo e vogël manifeston probleme emocionale të sjelljes dhe të shëndetit mendor. Këto janë pasojat e mungesës ose pamjaftueshmërisë së shërbimeve të përshtateshme nga strukturat përgjegjëse.

Gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2008, SOS Fshatrat e Femijve, Shqipëri, ndërmoi iniciativën për mbledhjen dhe analizen e informacionit për këtë kategori të rinjsh në Shqipëri. Qëllimi i këtij studimi ishte (a) vlerësimi i sistemit të mbrojtjes shoqërore në shërbim të rinjve që jetojnë në forma të përkujdesjes alternative dhe ata që lenë institucionet rezidenciale, (b) identifikimi i problemeve ligjore e institucionale, që lidhen me ofrimin e këtyre shërbimeve, dhe (c) formulimi i rekomandimeve për përmirësim. Vlerësimi u shtri në qytetet Tiranë, Shkodër, Elbasan, Korçë ku numri të rinjve pa kujdes prindëror që lenë kujdesin social është më i madh .

Shërbimet Sociale për të rinj pa kujdes prindëror janë pjesë e programit për reduktimin e varfërisë dhe programit për kujdesin social. Legjislacioni, i cili mundëson zbatimin e programeve të sipërpërmendura është ndërtuar ne përputhje me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Qeveria shqiptare si edhe Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve. Ndonëse në funksion të mireqenies dhe mbrojtjes se fëmijëve egziston një kuader ligjor e institucional i mirë, ai ka ende nevojë për përmirësim në drejtim të fokusimit ndaj të rinjve pa kujdes prindëror, e veçanërisht atyre që largohen nga përkujdesi, në adresimin e sfidave me të cilat ata përballen ne kete faze të jetes, gjatë moshës 14-18 vjeç dhe pas moshës 18 vjeç.

Studimi evidentoi që eksperienca e kujdesit rezidencial, luan rol kyç ne jetën dhe të ardhmen e ketyre të rinjve që largohen/lënë këtë shërbim. Mbulimi i dobet me shërbime mbështetese gjate periudhes kur të rinjtë lene institucionin (14-18 vjeç dhe pas 18 vjeç) e me pas, le gjurmë në jetën e tyre në të gjitha planet, arsimim, punësim, strehim etj. Kjo jo vetem thellon disavantazhet dhe i kthen në grupe me marginalizim të shumëfishtë, por edhe u dhunon një pjesë të mire të të drejtave bazë. Mungesa e informacionit mbi numrin e tyre, shpërndarjen dhe format me të cilat ata përpriqen të përballojnë problemet dhe nevojat, tregon se nuk janë ende prioritet të hartimit të politikave.

Megjithëse ka një numër aktorësh të qeverisjes qëndrore e asaj vendore, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre këtë kategori sociale, bashkëpunimi ndërmjet tyre mbart probleme të koordinimit, kompetencave dhe shkembimit të informacionit. Gjithashtu shpërndarja e burimeve financiare në mbështetje të të rinjve me shërbime, është i pamjaftueshem dhe nuk sjell ndryshime të qënësishme në pavarësimin e tyre. Studimi sjell eksperienca të disa pozitive të disa strukturave të përkujdesjes për të rinjte që lenë shërbimin rezidencial. Keto shërbime të administruara nga OJF si Qendra Tag, Tiranë, Shtëpia e Shpresës dhe Tjetër Vizion Elbasan, Maddonnina della Grappa Shkodër, SOS Fshatrat e Fëmijëve etj, janë modele të çmuara ne pasurimin e formave të shërbimit qe nxisin perfshirjen, pavarësimin dhe respektojnë të drejtat e të rinjve ne përkujdes. Gjithashtu këto modele hasin vështirësi të tjera në realizimin e misionit të tyre dhe përballojnë një pjesë të nevojave në fushën e të rinjve pa kujdes prindëror.

Mbështetur ne gjetjet, ky studim jep disa rekomandime lidhur me zhvillimin e shërbimeve që pavarësojnë të rinjte, që lenë përkujdesin: rekomandohet ngritja e shërbimeve gjatë dhe pas largimit të të rinjve nga institucionet; zhvillimi i programeve

¹ Social Monitor 2006 Inochenti research centre Florence

monitoruese pas largimit; zgjatja e kohës së qëndrimit në përkujdesje deri në përfundimin e shkollës së mesme; ngritja e qendrave ditore (ku ofrohen shërbime) për të rinjtë që janë larguar nga përkujdesi (15-18 vjeç) dhe fuqizimi i politikave aktive të punësimit për këtë kategori, pas moshës 18 vjeç.

Në drejtim të përmirësimit të aktivitetit të aktorë publike, rekomandohet: ndërtimi i një legjislacioni që rregullon kuadrin e largimit nga përkujdesja dhe fuqizimi i detyrimit të aktoreve të ndryshëm në mbështetjen e nevojave të kësaj kategorie; ndërtimi i kapaciteteve institucionale për monitorimin e standartit të jetesës të të rinjve me histori përkujdesi, në gjysëm pavarësi apo pavarësi të plote; përfshirja e tyre në Strategjinë Kombëtare për Femijët; përfshirja e alternative pozitive të mbështetjes të prezantuara nga OJF; nxitja e krijimit të klubeve/qendrave për të rinj me pjesëmarrje të përbashkët nga të rinj me familje dhe atyre pa kujdes prindëror me qëllim rritjen e bashkëjetesës sociale dhe reduktimin e stigmës ndaj këtyre të fundit; fuqizimi i advokacisë për një shpërndarje të drejtë të fondeve për shërbime të femijët dhe të rinjtë.

Në drejtim të SOS dhe operatorëve të tjerë në fushën e shërbimeve për të rinjtë, studimi rekomandon hapjen e shërbimeve në formën e komuniteteve rinore; forcimin e marrëdhënieve me organizata, aktorë qeveritare dhe donatorë; përhapjen e modelit të Komuniteteve Rinore; trainimin e stafëve të institucioneve rezidenciale në përputhje me standartet cilësore mbi largimin nga institucionet dhe ndërmarrjen e iniciativave advokuese për të luftuar stigmën ndaj të rinjve dhe fëmijëve pa kujdes prindëror.

1. HYRJE

Ky dokument paraqet një vlerësim të sistemit të mbrojtjes shoqërore për fëmijët dhe të rinjtë pa kujdes prindëror. Vlerësimi është realizuar nga një grup i kombinuar me ekspertë të pavarur dhe profesionistë të SOS Fshatit të Fëmijeve, Shqipëri përgjate periudhës Tetor-Dhjetor, 2008. Studimi është realizuar në qytetet e Tiranës, Elbasanit, Korçës, Shkodrës dhe Kukësit. Vlerësimi është përqëndruar mbi modelet dhe praktikën e shërbimeve sociale të ofruara për fëmijët dhe të rinjtë pa kujdes prindëror në strukturat alternative të mbështetjes në fazën e përgatitjes së tyre për të lënë strukturën dhe për tu pavarësuar e integruar në jetën normale.

Gjetjet dhe rekomandimet e bëra, pasqyrojnë mendimet dhe opinionet e ekspertëve si konkluzione të një analize të thelluar të informacionit të grumbulluar gjatë këtij vlerësimi si dhe analizave dhe studime të mëparshme të realizuara nga aktore të tjerë. Metodologjia e ndjekur është bazuar në (1) ekzaminimin e sistemit (kuadrin ligjor dhe institucional) të mbrojtjes sociale (2) analizë e detajuar e modeleve alternative të përkujdesit social për fëmijët dhe të rinjtë jashtë kujdesit prindëror në institucionet e përkujdesit (publike dhe jo publike²), (3) vrojtime të jetës së të rinjve në fazat përgatitore ose perfundimtare të pavarësisht.

1.1 Përshkrimi i ekipit të studimit

Teuta Shkenza, Drejtor Nacional i SOS Fshatrave të Fëmijeve Shqipëri, ndoqi dhe supervizoi zhvillimin e procesit të kërkimit

Znj.Mirela Muca dhe Znj.Vilma Kolpeja në rolin e konsulentëve të jashtëme, hartuan metodologjinë e vlerësimit, instrumentat e vlerësimit dhe hartuan raportin me gjetjet dhe rekomandimet.

Znj.Almandina Guma, në rolin e oficerës së advokacisë pranë SOS Fshatrave të fëmijëve Shqipëri, koordinoi procesin e kërkimit dhe bashkëpunoi aktivisht përgjate gjithë realizimit të studimit dhe hartimit të raportit.

Znj.Alketa Berzani, në rolin e koordinatorës së Kujdesit Rinor pranë SOS Fshatrave të fëmijëve Shqipëri, dhe Znj.Helga Smakaj, Koordinatorë e Projektit të Fuqizimit të Familjes Shkodër kanë lehtësuar lidhjen me aktoret e përfshirë dhe kanë realizuar mbledhjen dhe përpunimin e informacionit.

Znj.Elsa Osmani, Menaxhere e Programit të Fuqizimit të Familjes ka kontribuar me të dhënat me një studim të brendshëm realizuar nga SOS Fshatrave të Fëmijeve Shqipëri, lidhur me të rinjtë SOS të cilët kanë lënë përkujdesin e SOS.

Grupi i punës ka bashkëpunuar me institucionet vendimarrëse në nivel qendror dhe lokal, si dhe me institucionet dhe individë të institucioneve të shërbimeve sociale për fëmijët dhe të rinjtë pa kujdes prindëror.

1.2. Përshkrimi i shpejtë i procesit të analizës dhe i metodologjisë

1.2.1 Qëllimi

Objektivat e studimit janë: (1) të identifikojë boshllëqet ligjore dhe institucionale, që vështiresojnë kalimin e të rinjve pa kujdes prindëror drejt jetës së pavarur, (2) të vlerësojë disa modele të implementuara shqiptare të integritit social të të rinjve që kanë lënë përkujdesin, duke evidentuar anët e dobta dhe të forta, (3) të identifikojnë tregues të monitorimit për matjen e ndikimit të programeve të

² Shiko "Lista e institucioneve objekt i këtij studimi"

pavarsimit dhe integritet në jetën normale të të rinjve pa kujdes prindëror, në të ardhmen.

Hapi i parë i analizës ishte një rishikim i dokumentacionit lidhur me politikën, kuadrin ligjor dhe shërbimet ekzistuese lidhur me largimin nga format e përkujdesjes alternative, aktet nënligjore të strukturave rezidenciale dhe të politikave të SOS Fshatit të fëmijëve. Më konkretisht janë rishikuar këto dokumente kryesore: *Strategjia e shërbimeve dhe mbrojtjes sociale 2007-2013; Strategjia Ndër-sektoriale e rinisë 2007-2013; Ligji Nr. 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"; Ligji Nr. 8153 datë 31.10.2006 "Për statusin e jetimit"; VKM 659, datë 17.10.2005 "Mbi standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet rezidenciale të kujdesit për fëmijë"; Manuali mbi "Zbatimin e standarteve në institucionet rezidenciale të kujdesit për fëmijë"; Rregullore të institucioneve rezidenciale të përkujdesit për fëmijë; Manuale të SOS Fshatrave të fëmijëve, raporte e studime mbi të rinjtë në kujdes rezidencial dhe jashtë kujdesit dhe manuale dhe rregullore të aktorëve që punojnë në këtë drejtim*

Informacioni sasior është marrë nga burime zyrtare, (Zyra e Statistikave dhe Informacionit pranë SHSSH pranë MPCSSHB, INSTAT, MASH, lidhur me demografinë, të dhëna social - ekonomike, të dhëna mbi fëmijët në përkujdes rezidencial, numrin e shkollave publike me konvikt, në të cilat strehohen fëmijë dhe të rinj të cilët dalin nga institucionet publike rezidenciale), si edhe nga informacion nga faqet zyrtare të internetit të institucioneve ndërkombëtare³.

Informacioni cilësor vjen nëpërmjet intervistave individuale me ekspertë të politikave sociale, pranë MPCSSHB, me drejtues të OJF-ve, me punonjës të sistemit të shërbimeve sociale në nivel qendror e vendor⁴; intervistave individuale me punonjës të institucioneve rezidenciale; takimeve me grupe të fokusuar me të rinj që kanë dalë nga përkujdesi dhe pas përkujdesit, dhe observimeve të drejtperdrejta të rasteve të të rinjve që jetojnë në mënyrë të pavarur ose gjysëm të pavarur⁵.

Instrumentat e përdorur: (a) listë pyetjesh për intervistën e thelluar me të rinj jashtë përkujdesit; (b) pyetesore të strukturuar me pyetje të hapura për intervista me politikë-bërës dhe zbatues të politikave të përkujdesit për fëmijë, përfshirë edhe drejtuesit e institucioneve të përkujdesit, (c) listë pyetjesh të diskutuara përgjatë takimeve me grupet e fokusuar me të rinj në pra të lënies së përkujdesit dhe jashtë tij (d) shënime të mbledhura nga observimet gjatë vizitave në terren.

Kufizime të studimit: Kufizimi në kohë, mungesa/pamjaftueshmëria e informacionit të nevojshëm për të rinjtë jashtë përkujdesit dhe mosmbledhja e plotë e informacionit statistikor në strukturat përkatëse.

1.3. Përshkrimi i aktorëve të përfshirë në proces

Gjatë përgatitjes së këtij raporti, ekipi kërkues bashkëpunoi dhe u konsultua me disa aktorë nga agjensitë shtetërore dhe shoqëria civile, kryesisht me organizatat me aktive që punojnë në mbështetje të të rinjve dhe fëmijëve jashtë kujdesit prindëror.

Gjithashtu të rinj në prag të daljes nga përkujdesi dhe të rinj jashtë përkujdesit, ishin pjesë e rëndësishme e këtij procesi përfshirës dhe konsultues. Disa takime individuale dhe takime me grupe me këto dy kategori, ofruan një ndihmë (insight) në të kuptuarit e shumë problemeve dhe sfidave me të cilat ata përballen.

³ Shih "Bibliografia" dhe referencat

⁴ Listen e dokumentacionit të analizuar si dhe listen e personave të intervistuar do ta gjeni në Aneksin 2 të këtij dokumenti

2. INFORMACION SOCIAL, KULTUROR DHE POLITIK

Shqipëria po kalon një periudhë relativisht të gjatë tranzicioni, e cila në shumë aspekte konsiderohet të jetë më e vështirë se në shumë vende të tjera të Europës Qendrore dhe Juglindore. Pas viteve 90-të, Shqipëria pësoi ndryshime të rëndësishme politike, ekonomike dhe sociale. Fenomene të pa pranuar gjatë regjimit komunist, si varfëria, papunësia, migrimi masiv brenda dhe jashtë vendit, trafikimi i qenieve njerëzore, problemet sociale brenda familjeve shqiptare (dhuna, divorci, prostitucioni etj), kanë çuar në krijimin e kategorive sociale në rrezik, midis të cilëve femijët jashtë kujdesit prindëror janë edhe ndër me të marginalizuarit.

Popullata Totale (000)⁶	3,170
Popullata e të rinjve (%) (0-17 vjeç)	32.6
Popullata nën vijën e varfërisë(%)⁷	18.5
Mosha mesatare⁸	78.6
Indeksi I Edukimit⁹	0.887
GDP për kokë¹⁰ në USD	5,316
Standarti i jetesës(ndihma ekonomike për familje në një muaj në leke)¹¹	7,000
Indeksi i Zhvillimit Human¹²	0.801
Indeksi i zhvillimit gjinor¹³	0.797
Shkalla e papunësisë (%)¹⁴	13
Shpenzime publike në shëndet(në % të shpenzimeve publike totale)	8.4
Shpenzime publike në shëndet (në % of GDP¹⁵)	2
Shpenzime publike në arsim në % të shpenzimeve publike totale	11
Shpenzime publike në arsim (%) në % të GDP	3.5
Shteti	Ish vend komunist/ Republike parlamentare

⁶ Shifrat e kësaj tabele janë marre nga Raporti vjetor 2007 Banka e Shqipërisë.

⁷ LSMS 2005

⁸ <http://ëëë.instat.gov.al/graphics/doc/tabelat/Treguesit%20Sociale/Lindje%20e%20vdekje/LDV%202004/ldv13.xls>

⁹ http://hdrstats.undp.org/countries/data_sheets/cty_ds_ALB.html

¹⁰ ibid

¹¹ VKM 787 date 14.12 2005 "Per percaktimin e keritereve dhe mases se ndihmes ekonomike"

¹² http://hdrstats.undp.org/countries/data_sheets/cty_ds_ALB.html

¹³ Ibid

¹⁴ Banka e Shqipërisë "Raporti vjetor 2007"

¹⁵ Ministria e Financave-Drejtoria e Buxhetit (te dhena për vitin 2008)

3. INFORMACION MBI SISTEMIN E PËRKUJDESIT PËR FËMIJË E TË RINJ

Sistemi i përkujdesit Social për femijët pa kujdes prindëror paraqitet si një sistem formal dhe informal. Sistemi formal i përkujdesit është i mbështetur në një seri ligjesh, rregullash dhe institucionesh të cilat e kanë zanafillen në sistemin e vjetër ekonomik-shoqëror, por që janë zhvilluar e përmirësuar sipas modeleve bashkekohore.

Sistemi formal i përkujdesit për femijët pa kujdes prindëror, përbëhet prej: a) shërbimit të birësimit; b) përkujdesit në “shtëpi-familje” të prezantuara dhe administruara nga disa organizata të huaja, përfshirë SOS Fshati i Fëmijëve në Shqipëri; c) përkujdesit nëpermjet kujdestarisë (foster care) i cili është ende në fillimet e veta; d) përkujdesit rezidencial i tipit institucional (shtëpitem për femijët 0-6 vjeç dhe 6-14 vjeç); e) përkujdesit ditor në qendra për femijë me probleme sociale (lypesat, femijët e rruges); f) shërbime ri-atdhesimi dhe ri-bashkimi me familjen, për të miturit e larguar nga Shqipëria.

Shërbimet e përkujdesit për femijë dhe të rinj jashtë kujdesit prindëror realizohen nëpërmjet zbatimit të programit për reduktimin e varfërisë dhe programit për kujdesin social. Legjislacioni i cili mundëson zbatimin e programeve të sipërpërmendura është pjesë e politikës sociale, në përputhje me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga qeveria shqiptare si edhe Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve.

3.1. Legjislacioni kryesor që përcakton sistemin e përkujdesit për femijë e të rinj.

3.1.1 Kuadri ligjor dhe politik

- **Kushtetuta e Shqipërisë**, miratuar sipas Ligjit Nr. 8417, datë 21/10/1998 dhe shpallur me dekret Nr. 2260, datë 28.11.1998, është ligji themelor që siguron mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në përgjithësi dhe të atyre të cilëve iu mungon kujdesi prindëror në veçanti. Kushtetuta e re e Shqipërisë përmban një kapitull të veçantë mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të qytetarëve si edhe një kapitull tjetër mbi objektivat sociale. Këta kapituj sanksionojnë detyrimin e shtetit për sigurimin e kujdesit dhe ndihmës gjatë të gjithë procesit të rritjes, zhvillimit dhe edukimit, për femijët, të cilëve iu mungon kujdesi prindëror (neni 59/e). Kushtetuta e Shqipërisë është *e fokusuar te gratë, fëmijët dhe të rinjtë*.
- **Konventa e Kombeve të Bashkuara “Mbi të drejtat e femijeve”** e ratifikuar nga Qeveria Shqiptare në Shkurt 1992, hyri në fuqi në Mars 1992. Nga konventa, rrjedhin detyrime që lidhen me respektimin e të drejtave të fëmijëve, të udhëhequra nga parimi i respektimit të “interetit më të mirë të fëmijës”. Ratifikimi i Konventës është hapi fillestar në krijimin e sistemeve institucionale që sigurojnë mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të fëmijëve jashtë kujdesit prindëror.
- **Karta Sociale Europiane** (e rishikuar) sipas VKM¹⁶ 458, dt.27.04.1998, e cila njih dhe mbron të drejtën për të përfituar shërbime sociale. Megjithatë, duhet nënvizuar se qytetarët e njohin pak kuptimin dhe përfitimet e kesaj Karte.
- **Konventa e ILO**¹⁷ Nr.138 “Mbi moshën minimale të lejuar të punës” e ratifikuar në vitin 1998 dhe konventa Nr. 182 “Mbi ndalimin dhe veprimin për eliminimin e të gjitha formave të punës së fëmijëve” e ratifikuar në vitin 2001”.

¹⁶ Vendim i Këshillit të Ministrave

¹⁷ Organizata Ndërkombëtare e Punës

- **Konventa e Hagës** e vitit 1993 mbi “ Mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin në lidhje me birësimet ndërkombëtare” e ratifikuar me ligjin Nr 8624, datë 15.06.2000.
- **Kodi i Familjes** (Ligji Nr.9062, date 8 Maj 2003) përcakton detyrimet institucionale të shtetit ndaj fëmijëve jashtë kujdesit prindëror si edhe mënyrën se si zbatohen ato.
- **Kodi i Procedurës Civile**, miratuar me ligjin Nr 8116, datë 29. 3. 1996, në nenet 351/1, 352 ka parashikuar se: “Kërkesa për vendosjen e kujdestarisë i paraqitet gjykatës nga të afërmit e fëmijës së mitur dhe nga cilido që merr njoftimin për mbetjen e fëmijës pa prindër, për lindjen e një fëmije me prindër të panjohur dhe për çdo rrethane tjetër që ligji kërkon vendosjen e kujdestarisë si dhe ushtrimin e kësaj të drejte nga vetë i mituri kur ai ka mbushur moshën 16 vjeç. Gjithashtu, sipas nenit 356/1 "gjykata, përpara se të procedojë për emërimin e kujdestarit, duhet të pyesë edhe të miturin, kur ai ka mbushur moshën 10 vjeç.
- **Kodi penal shqiptar**. Kodi i hartuar ne 1995, përcakton moshën 14 vjeç si moshe mbi të cilën çdo personi i njihen përgjegjësite për veprime në kundërshtim me ligjin (neni 12), në moshën 16 vjeç veprimet në kundërshtim me ligjin janë të dënueshme. Vendimet për dënim me burgosje për të miturit, nuk duhet të kalojë gjysmën e kohës të dënimit të parashkruar nga ligji për atë veper penale)(neni 51). Gjykata gjithashtu mund të evitohet dënimi me burg të minoreneve dhe përcaktojë vendosjen e tyre në “institucione edukimi”(neni 52). Trafikimi i fëmijëve është gjithashtu i dënueshem nga ligji. Shfrytëzimi i fëmijëve nëpërmjet lypjes, është i klasifikuar si një veper kriminale e vecante. (janar 2008).
- **Ligji Nr.7650, datë 17.12.1992** “Për Birësimin e të Miturve nga Shtetas të Huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes”. Hartimi dhe miratimi i Ligjit nr. 7650 datë 17. 12. 1992 i ka paraprirë Aderimit të Shqipërisë në Konventën e Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin në birësimin jashtë vendit”. Ky ligj përcakton procedurat pas deklarimit të fëmijës si të braktisur. Në këtë ligj theksohet se fëmija deklarohet i braktisur kur prindërit në mënyrë të dukshme nuk kanë shfaqur interesim për të pergjate një viti, para paraqitjes së kërkesës për deklarimin e braktisjes nga gjykata. Gjithashtu gjykata jo vetem që deklaron të braktisur fëmijën, por gjithashtu vendos për të edhe një sistemim afatgjate në një forme perkujdesjeje (kryesisht merr vendime për vendosjen e tij në institucione perkujdesi rezidencial).
- I përmirësuar me **Ligjin Nr. 9695, Datë 09.03.2007, “Për birësimin e të miturve”**
- **Ligji Nr. 8153, datë 31.10.1996, “Mbi statusin e jetimit”** mbulon vetem një pjese të kategorise se fëmijëve jashte kujdesit prindëror –jetimëve biologjikë dhe ata që i përkasin familjeve që iu është hequr përgjegjësia prindërore. Sipas këtij ligji, përfituesit janë fëmijë dhe të rinj 0-25 vjeç, pavarësisht nëse janë trajtuar ose jo në institucionet shtetërore ose private të perkujdesit shoqëror. Për kete kategori femijesh ky ligj përcakton: menyren e vendosjes së fëmijëve në institucionet e perkujdesit shoqëror dhe kohën e qëndrimit në to (deri në moshën 14 vjeç, dhe në raste të veçanta deri në moshën 17 vjeç)¹⁸; arsimimin nepermjet sigurimit të një burse studimi; mbeshtetjen me ndihme ekonomike pas moshes 18 vjeç nese ata janë të papunë e pa të ardhura; si edhe mundeson sherbim falas ne sherbimin shendetesor, transport public dhe aktivitete kulturore e sportive. Ne menyre të vecante ky ligj I përcakton kete kategori, si grup prioritar ne punesim, (perfshire

¹⁸ Në kohën kur është miratuar ligji arsimi I detyruar ishte 8 vite shkolle dhe perfundonte ne moshen 14 vjeç, duke filluar nga viti shkollor 2007 dhe 2008, arsimi I detyruar është 9 vite shkolle dhe perfundon ne moshen 15 vjeç.) megjithate Ligji ne fjale nuk ka ndjekur ndryshimet ne ligjin e arsimit parauniversitar. për rrjedhoje nuk janë bere ndryshimet ne Ligjin 8153, date 31.10.1996

emigracionin e organizuar) dhe strehimin. Statusi jepet sipas vendimit të një komisioni të veçantë, të krijuar pranë ShSS¹⁹, në të cilin përfshihet edhe një përfaqësues i shoqatës së fëmijëve jetimë. Legjislacioni parashikon dhe rregullon mënyrën e trajtimit të fëmijëve jashtë kujdesit prindëror në institucionet e përkujdesit shoqëror²⁰.

- **Ligji Nr.9355, datë 10.03.2005 “Për Ndhimën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore”, i hartuar mbi ligjin Nr. 7710 dt. 18.05.1993 “Për Ndhimën dhe Përkujdesin Shoqëror”, ndryshuar me ligjin Nr.7886, dt.08.12.1994 dhe ligjin nr. 8008, dt. 05.10.1995, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre (VKM Nr 307, VKM Nr.510) përcaktojnë sistemin e ndihmës ekonomike dhe të përkujdesit shoqëror për qytetarët shqiptarë, në të cilin përfshihen edhe fëmijët jashtë kujdesit prindëror. Ajo përfshin strukturën dhe tipologjinë, mënyrën e organizimit, financimin dhe rregullat e pranimit në institucione.**

Gjithashtu ligji përcakton edhe definicionet që lidhen me perfituesit nga shërbimet që ofron ky ligj si: jetim, persona me aftësi të kufizuara, shërbime shoqërore, ndihme ekonomike, familje kujdestare, etj. Përfitues të shërbimeve shoqërore janë edhe fëmijët (ku përfshihen edhe fëmijët jashtë kujdesit prindëror), të rinjtë deri në moshën 25 vjeç, personat me aftësi të kufizuara si edhe ata që janë grup në nevojë apo në risk për të qene pjesë në grupet në nevojë.

Ligji përcakton (neni 5/2) se janë perfitues të ndihmes ekonomike, kategoria e jetimeve 18 -25 e mbi 25 vjeç nese janë të papune e pa të ardhura dhe që nuk mbeshteten nga institucionet e përkujdesit apo me kujdestari.”

- **Ligji i organizimit dhe funksionimit të qeverisjes vendore Nr. 8652 datë 31.07.2000 krijon kushtet e nevojshme për decentralizimin e shërbimeve shoqërore. Megjithatë, duhet të nënvizohet se decentralizimi financiar ende nuk mund të realizohet në çdo njësi të pushtetit vendor, sepse burimet vendore të sigurimit të financimit janë të kufizuara.**
- **Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.307, dt. 24.05.1994²¹ “Për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror” është hartuar dhe miratuar në zbatim të ligjit nr.7710. Sipas këtij vendimi, shërbimet e përkujdesit shoqëror (për fëmijët dhe të rinjtë pa kujdes prindëror) që financohen nga buxheti i shtetit përfshijnë:**

Shërbime sociale në institucione rezidenciale: Sigurohen për fëmijë jetimë dhe të braktisur, si edhe për fëmijë me aftësi të kufizuara. Shërbimet e përkujdesit për fëmijë sigurohen nga pushteti qendror, pushteti lokal, organizatat joqeveritare dhe nga persona private. Autoritetet lokale ofrojnë “shërbime jashtë institucionale”, ndërsa institucione qendrore si MPÇSShB ofrojnë shërbime institucionale.

- **Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 510, dt. 24.11. 1997²² “ Kriteret e vendosjes në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqëror dhe dokumentacioni i nevojshëm për pranim” përcakton rregullat e pranimit në institucione të fëmijëve pa kujdes prindëror.**
- **VKM 658, 659 date 17.10.2005 “Per standartet e shërbimit të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale”²³.Ky Vendim i Këshillit të Ministrave përcakton 11 standarte të përkujdesit në institucionet e përkujdesjes për fëmijë: Pershtatshmeria e shërbimit; Plani individual i përkujdesjes; Pergatitja për jetesë të pavarur; Ushqyerja;**

¹⁹ Shërbimi Social Shtetëror

²⁰ Në mënyrë të hollësishme të drejtat që mbrohen ky ligj janë shpjeguar në paragrafin 3.5

²¹ Me hartimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore, ky vendim duhet të shfuqizohet. Por meqenëse këto akte nuk janë hartuar akoma, atëherë VKM e sipërshtuar është ende në zbatim.

²² Me hartimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore, ky vendim duhet të shfuqizohet. Por meqenëse këto akte nuk janë hartuar akoma, atëherë VKM e sipërshtuar është ende në zbatim

²³ Standartet kanë zëvendësuar rregulloret sipas të cilave funksiononin institucionet e përkujdesit shoqëror

Paraqitja veshja dhe nevojat materiale; Shendeti fizik, emocional e mendor; Edukimi; Argetimi; Ankimimi; Mbrojtja nga abuzimi; Mjedisi dhe akomodimi; Stafi; Menaxhimi.

- Ligji mbi strehimin social, Nr. 9382, i vitit 2004 , ofron një kuader ligjor për zhvillimin e politikave dhe programeve për strehimin social ne njesite e pushtetit vendor (bashki e komuna). Kategoria e individëve pa kujdes prindëror që gëzojnë statusin e jetimit (sipas ligjit 8153, 1996) dhe me moshe nen 30 vjec, perfshihen si kategori që perfton strehim social.

3.2. Legjislacioni kryesor për të rinjtë që lënë përkujdesin

Ne VKM 658, 659 date 17.10.2005 “Per standartet e sherbimit të përkujdesit shoqeror për femijët ne institucionet rezidenciale: Ne standartin e 3-te, parashikohet hartimi i planit pergatitor për femijët që largohen nga perkujdesja ne shetpi ose levizin ne forma të tjera të perkujdesjes, sic janë kthim ne familje, biresim, kujdestari, jete e pavarur ose gjysem e pavarur. një ekip profesionistesh të institucionit (edukatore, punonjes social, kujdestare) dhe familja e origjines dhe femijët hartojne planin pergatitor për largimin nga perkujdesja sipas nevojave të vleresuara të femijes.

Ligji mbi strehimin social, No. 9382, 2004 Mbështet strehimin social nga Bashkitë dhe komunat . Ndër kategoritë përfituese janë ata që kane statusin e jetimit dhe kane moshe nen 30 vjec.

VKM Nr. 80, date 28.01.2008 “Për kujdestarinë/ foster care – ende ne fillimet e saj. Aktualisht është hartuar një dokument i Kujdestarisë për fëmijë miratuar me VKM si dhe janë hartuar standartet e shërbimit të kujdestarisë si një hap pozitiv në shërbim të fëmijëve dhe të rinjve.. Kujdestaria për femijet, është pjesë e Strategjisë Sektoriale të Mbrojtjes Sociale dhe parashikon kujdesin ne familje kujdestare për fëmijë jashte kujdesit rinderor. Ky dokument zgjeron shërbimet alternative për femijët në nevojë drejt formave që ofrojnë përkujdes në një mjedis familjar. Ky dokument është në procesin e hartimit të akteve nënligjore që e mbeshtesin si dhe udhëzimet perkatëse.

3.3. Strukturat e përkujdesies për të rinjtë e grupmoshës 15-24 vjec

Ekzistojnë disa lloje strukturash që përkujdesen për të rinjtë me histori përkujdesi të grupmoshës 15 -24 vjec përgjate kohës që janë ënë procesin e daljes nga përkujdesi dhe jashtë tij. Ato janë (a) struktura rezidenciale publike dhe jo publike, (b) shkollat publike me konvikt, dhe (c) struktura rezidenciale rinore të tipit familje).

Përgjatë ketij studimi u identifikuan 34 struktura të tilla, sipas ndarjes së meposhtëme.

Institucioneve rezidenciale publike dhe jo publike dhe struktura të tipit Shtëpi-Familje për fëmijë 0-17 vjec. Numri i këtyre strukturave të identifikuara deri tani është 17. Femijët qendrojnë në këto struktura deri ne moshën 15 vjec ose 17 vjec. Të tilla janë strukturat publike të përkujdesit për femijë jashte kujdesit prindëror (*Shtëpita e fëmijëve ne Durres, Tirane, Shkoder, Sarande, Vlore*) dhe strukturat e përkujdesit për fëmijë jashte kujdesit prindëror të administruara nga OJF (si *SOS Fshati i fëmijëve –Shqiper²⁴i, “Shtëpia e shpreses” ne Elbasan, “Misionaret e bamiresise”, “Rreze Drite” dhe “Pueri Domini ne Tirane”, “Fillimet e Reja ne Berat dhe “Betania”ne Kruje.*

²⁴ 13 fëmijë të grupmoshes 14 -16 vjec ndodhen aktualisht ne strukturat shtëpi familje ne pritje për tu transferuar ne strukturat rinore.

Konviktet e shkollave të mesme profesionale publike- aktualisht 9, ofrojne mbështetje për adoleshentet e të rinjtë me histori kujdesi residenciale. Të rinjtë duhet të qëndrojnë përgjatë kohës që ndjekin shkollën e mesme deri në moshën 18-19 vjeç (në varesi të viteve të shkollës). Ne realitet këto struktura ofrojne strehim për pjesën më të madhe të të rinjeve që lenë përkujdesin. Të tilla janë: konviktet e QFP4, Politeknikumt, dhe shkollës se Mesme Teknologjike ne Tirane; konviktet e shkollës se Ndertimit, shkollës Mekanike dhe shkollës se Mesme Teknologjike ne Shkoder; konviktet e shkollës se Mesme Tregtare ne Vlorë; shkollës se Mekanikes Bujqesore në Durrës, shkollës se Mesme Bujqesore në Berat, shkollës së mesme në Korçë.

Një pjesë e konsiderueshme e të rinjve vazhdojnë të qëndrojnë në konvikte edhe pas moshës adulte, si alternative e vetme e strehimit të tyre.

Shtëpi familje per të rinjtë (15 -24 vjec) janë aktualisht 8. Koha e qendrimit në këto struktura varion nga 7-9 vjet dhe kryesisht perbëhen nga shtëpите e të rinjve dhe shtëpите gjysëm të mbojtura. Të tilla struktura janë Komunitetet Rinore të SOS Fshatrat e Femijëve; Apartamentet e Mbrojtura dhe Apartamentet e Autonomise së Lartë të "Tjeter Vizion" dhe "Home and Hopes" ne Elbasan, Casa -famiglia" për të rinjtë të Maddonina Del Grappa, Projektit Shpresa dhe Pappa Giovanni XXII, në Shkodër dhe Qendres TAG në Tiranë.

Mosha e daljes nga përkujdesi dhe mosha e pavarësisë për të rinjtë shqiptarë.

Në legjislacionin aktual (në Standartet e shërbimit të përkujdesit për femijë) percaktohet vetem mosha minimale kur femijët duhet të fillojne procesin për daljen nga përkujdesi drejt autonomise se plote dhe kjo moshe është -14 vjec²⁵. Ne strukturat e përkujdesit social publik, femijët fillojne jetën e pavarur ne moshen 15 vjeç e ne pak raste edhe ne moshen 17 vjec, për kete arsye procesi I lënies së përkujdesit zgjat 1 ose 2 vjet. Ne strukturat e drejtuara nga OJF, procesi fillon pas moshes 14 vjec, por qendrimi ne struktura mbeshtetese, zgjat për një kohe me të gjate.

Kur adoleshentet jashte kujdesit prindëror arrijne moshen për të dale nga institucionet e përkujdesit (publik apo të drejtuara nga OJF), ne me të shumten e rasteve ata konsiderohen si të rritur që nuk kane me nevoje për tu mbeshtetur nga sistemi i perkujdesit. Por ndersa bashkemoshataret e tyre që jetojnë ne familje, vazhdojne të marrin perkujdesje dhe ndihme nga prinderit edhe për shumë kohe pas kesaj moshe, ne vecanti institucionet publike të përkujdesit "heqin" dore shumë heret dhe nuk i mbeshtesin apo i mbikqyrin me, pas moshes 15 vjeç.

Mosha, ne të cilen behen të pavarur, pjesa me e madhe e adoleshenteve dhe të rinjve shqiptare që jetojnë ne familje, është mbi 25 vjec. Kjo moshe perkon me kohen kur ata mbarojne shkollën e larte apo pasi ata ndjehen financiarisht dhe emocionalisht të afte për të qene të pavarur nga familja. Megjithese nuk ka studime mbi moshen e të rinjeve apo të rriturve që vazhdojne të jetojnë me familjen, vëzhgime të jetes së perditeshme tregojne se kjo moshe leviz ndermjet 25-35 vjec.

Ndersa femijët e të rinjtë që jetojnë ne familje, behen të afte për të qene të pavarur, pas moshes 25 vjec, një pjese e adoleshentet/ te rinjve ne përkujdesin i social publik u duhet të jene të pavarur dhe të vetnjaftueshëm menjehere pasi mbushin 15 vjeç ose 19 (nese perfundojne shkollën e mesme), pamwaresisht faktit nese nga pikpamja e zhvillimit të gatshem apo jo duke marrë në konsideratë edhe mungesën e shërbimeve në momentin e largimit nga përkujdesja.

²⁵ Ne rast se femija le strukturat e perkujdesjes rezidenciale me pare se kjo moshe atehere edhe ky proces fillon me heret kjo moshe është percaktuar vite me pare kur shkolla e detyruar ishte 8 vite dhe perfundimi i saj behej ne moshen 14 vjeç .

Ne ndryshim nga bashkemoshataret e tyre të cilët ne rast nevojë mund t'i kërkojnë ndihmë e mbështetje emocionale apo materiale familjes, të rinjtë që dalin nga sistemi i përkujdesit ose nuk kanë lidhje të forta me familjen apo të afërmit ose i kanë humbur këto lidhje. Të filluarit e një jete të pavarur ne moshe të re është një situatë shumë stresuese dhe e shoqëruar me ankth dhe frikë. Të rinjtë me histori kujdesi në strukturat publike, janë edhe me rrisht. Në momente të vështira të jetës kur ata kanë me shumë se kurrë nevojë për mbështetje, ata ndihen të abandonuar nga ai sistem që i përkujdes. Shumë prej tyre që vazhdojnë shkollën e mesme, perserisin vitin shkollor, për të vonuar daljen nga institucioni apo mbarimin e shkollës së mesme. Shumë prej tyre kanë probleme të sjelljes, arsimit dhe përshtatjes në një realitet të ti social, duke qenë në këtë mënyrë edhe më të rrisht.

Lënia e përkujdesit dhe mbështetja pas përkujdesit. Koha e qëndrimit në përkujdesje dhe mbështetja pas përkujdesit është e ndryshme dhe në funksion të disa faktoreve, individuale, shëndetësore apo në varesi të perqasjes që ofrojnë institucionet publike apo të drejtuara nga OJF.

Një pjesë e fëmijëve nga strukturat publike të përkujdesit, terhiqen dhe mbahen në kujdesin e strukturave të tipit shtëpi – familje të drejtuara nga OJF. Kjo është edhe pjesa më me “fat”. Një pjesë tjetër, dërgohet të vazhdojnë shkollën të mesme me konvikt dhe trajtohen me burse, ndërsa ata që e kanë mbajtur lidhjet me familjen kthehen, në familjen biologjike.

Një punë intensive realizohet nga OJF që operojnë për riintegrimin e fëmijëve në familjet biologjike si alternative më e mirë, duke u bazuar edhe në mungesën e shërbimeve të mëtejshme mbështetëse që do të mundësonin pavarësimin e tyre vetjak.

Situata është me pozitive në sistemin e drejtuar nga OJF në të cilat mosha e daljes në pavarësi është me e madhe dhe mbështetja ka një shtrirje kohore me të gjatë. Në sistemin e përkujdesit SOS, Fshati I Fëmijëve- Shqipëri, fëmijët kalojnë nga shtëpitë SOS në komunitetin rinor SOS në moshën 15 vjeç dhe qëndrojnë atje deri 19 vjeç. Me pas ata trajtohen nga programe që mbështesin pavarësinë deri në moshën 24 vjeç.

Qendra Tag Tiranë tërheq të rinjtë nga shtëpitë e fëmijës dhe kujdeset për ta deri në moshën 18 vjeç duke suportuar arsimin, kurset profesionale si dhe rritjen e aftësive të të rinjve.

Disa OJF të tjera kanë në fokusin e aktivitetit të tyre mbështetjen për fëmijët që dalin nga institucionet publike pas moshës 15 vjeç, të cilët nuk mund të vazhdojnë arsimin e mesëm, por që ndërkohe ju duhet të lenë institucionet publike të përkujdesjes për shkak të moshës. Disa OJF të tjera ofrojnë mbështetje për fëmijët të braktisur kryesisht të referuara nga institucionet fetare, shërbimi social lokal, OJF në mbrojtje të fëmijëve.

Dalja nga përkujdesi dhe shërbime pas përkujdesit për të rinjtë të cilët dalin nga strukturat publike.

Në shtëpinë-familje të Maddoninna della Grappa (një OJF që vepron në Shkodër) ndodhen 7 vajza të grupmoshës 14-18 vjeç. Fëmijët kanë ardhur në këtë shtëpi në moshën 14 vjeç, nga institucioni publik i përkujdesit të këtij qyteti, dhe do qëndrojnë deri sa të behen 18 vjeç. Pas kësaj moshe ato do transferohen në një shtëpi “gjysem të mbrojtur” dhe ku do të fillojnë të bëjnë një jetë autonome për edhe 2 vjet të tjera. Me pas ato do të fillojnë një jetë totalisht të pavarur. Kjo inisiativë ka filluar në vitin 2008.

Dalja nga institucioni publik ne moshën 15 vjeç është e lidhur me perfundimin e aresimit të detyruar. Për ata që vazhdojnë një shkollë të mesme perkujdesja “vazhdon” me dergimin e tyre ne shkolla me konvikte dhe ofrimin e një burse studimi për rreth 4 ose 5 vjet kjo kategori ka të “garantuar” fjetjen, edukimin, ushqimin dhe plotesimin e disa nevojave baze. Me pas ata perfitojnë vetem një ndihme ekonomike mujore nese janë të papune dhe pa të ardhura. Ne kete moshe fillon edhe pjesa me e veshtire e jetës. Mungesa e një strehimi kushtëzon që pjesa me e madhe e tyre të vazhdojnë të jetojnë ne konvikte edhe pas mbarimit të shkollës se mesme, pa mbeshtetje nga dikush.

Apartamentet e Mbrojtura janë struktura që mbeshtetin perkatesisht fëmijë (15-18 vjeç) dhe të rinj (19-23 vjeç) të braktisur. Ato menaxhohen nga Shtëpia e Shpresës Elbasan. Apartamentet e Autonomisë së lartë janë menaxhuar nga një OJF tjetër, Tjetër Vizion në Elbasan, por aktualisht janë mbyllur për shkak të koston të lartë dhe prioriteti kryesor në këtë drejtim për këtë organizatë është mbeshtetja e të rinjve për tu bashkuar me familjet biologjike duke I ndërgjegjësuar këto të fundit.

Edhe të rinjtë e larguar nga format e perkujdesit nga OJF hasin vështirësi dhe përballen me mungesën e shërbimeve të mëtejshme për ta.

E.A një e re e larguar nga perkujdesi SOS Fshati i Femijeve- Shqiperi, ndodhet aktualisht ne program gjysem pavaresie, tregon se kushtet e banimit i ka të mira. Apartamentin e ndan me një shoqe, por mendon që vitin e ardhshem të kerkoje dy vajza të tjera për të ndare qerane. SOS Fshati i Femijeve- Shqiperi, i paguan qerane e shtepise prej 25,000 ne muaj. Është e punesuar, por me të ardhurat nuk e perballon jetesen. Ka frike nga e ardhmja. Ajo ka deshire të vazhdoje universitetin. Shkollën dhe punen i realizoj vete,- thote ajo, por për strehimin është e nevojshme një mundesi mbeshtetje nga shteti

Burimi : Intervista me të rinjtë ne perkujdesje dhe stafin e OJF

3.3.1 Strukturat e perkujdesjes për të rinj me aftësi e kufizuar

Për fëmijet/adoleshentet me aftësi të kufizuar, qëndrimi në perkujdes është më i gjate dhe dalja nga perkujdesi shoqërohet ose me bashkim familje ose sistemimin e tyre perfundimtar në qendra për të rritur me aftësi të kufizuar, ku aplikohet gjysëm pavaresia.

Shtepite familje për të rinj e adulte me aftësi të kufizuara - Shkoder

Ne Shkoder, Maddonnina della Grappa, ka ngritur dhe po financon mbajtjen e një shtepie familje me 18 të rinj e adulte me aftësi të kufizuara e të braktisur. Një pjese e tyre kane ardhur nga Qendra e Zhvillimit e Shkodres, ndersa disa të tjere janë referuar nga OJF e Sherbimi Social Lokal.

Burimi: Intervistat me drejtues të OJF

Për të rinjtë me aftësi e kufizuara mbeshtetja nuk ka kufi kohor. Numri i femijeve/te rinjeve me aftësi të kufizuar jashte kujdesit prinderor, është relativisht i ulet. Reforma de-institucionalizuese ne sistemin e shërbimeve për fëmijë me aftësi të kufizuar, i ka kthyer Qendrat e Zhvillimit²⁶ nga institucione rezidenciale ne qendra ditore sherbimi dhe pjesa me e madhe fëmijëve që ndodheshin ne to, janë

²⁶ institucione për rehabilitimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar

ribashkuar me familjen. Kur bashkimi me familjen është i pamundur, një pjese (ata që vuajne pa-aftesi të renda) dergohen ne azilet e pleqve, ndersa të tjeret ne qendra rezidenciale apo shtepi familje për të paaftë të rinj e adulte. Ne të dy rastet perkujdesi do të jete i vazhdueshem dhe pa limit kohor. Dergimi i të rinjeve me paaftesi të renda ne azilet e pleqve behet për mungese strukturash perkujdesjeje për kete kategori. Strukturat rinore të administruara nga OJF kane kapacitete të vogla dhe të pa strukturuara për shërbime për individe me paaftesi të renda. Aktualisht vetem Shtepite për të moshura, mundesojne kujdesjen nga pikpamja shëndetësore, por ato dëmtojne rëndë anën emocionale dhe sociale të kesaj kategorie.

3.4. Shërbimet përgatitore për lënien e përkujdesit

Në përputhje me dokumentin e Standarteve të përkujdesit për femijët jashtë kujdesit prinderor, kur një fëmijë mbush moshën 14 vjeç ose edhe me pare, realizohet një vleresim i nevojave i cili i paraprin planit individual të levizjes/daljes ne jete të pavarur (pathëay planning) sipas një standarti të miratuar nga MPCSShB. Plani i cili emertohet «Plani im për të ardhmen» realizohet nga një grup ekspertesh ne të cilin bejne pjese kujdestari i femijes, punonjesi social dhe psikologu. Femijet, gjithashtu raportohet, të jenë pjeëe, gjate hartimit të ketij planit individual. Ne rastet ku femijet/adoleshentet e kane një familje biologjike dhe mbajne mardhenie me te, atehere edhe familja perfshihet.

Plani i pergatitjes për një jete të pavarur percakton hapat për kthimin e femijes ne familjen biologjike nese kjo është e mundur, ose harton drejtimet e mbeshtetjes se metejshme nga ku me të rendesishmet janë sigurimi i një strehimi sa me të pershtatshem, mbeshtetja për të vazhduar arsiminim (kur femija/adoleshenti ka aftesi të mjaftueshme të mesim-nxënies), ofrimin e kurseve profesionale apo të një punesimi, mbeshtetja me ndihme ekonomike, aftesimin mbi kryerjen e aktiviteteve baze të vetembeshtetjes (kujdesi personal, aftesia për vendimarrje dhe zgjidhje problemesh, orientim për ndihme ne rast nevojë) si edhe informim , keshillim dhe udhezime për ceshtje që lidhen me evitimin e sjelljeve seksuale me risk (HIV/AIDs, STS-ve), kryerjen e një jete normale të shëndetshme larg droges, alkolit, prostituimit apo shtatzanive të hereshme), mosperfshirjen ne veprime e aktivitete të paligjeshme (si vjedhje apo delinkence). Pjese e pergatitjes është edhe njohja me historine personale të femijes/adoleshentit dhe mbajtja e kontakteve me familjen, kur është e mundur. Keto plane rishikohen sa here kjo është e nevojshme.

- Ne rastin kur femija do të bashkohet me familjen natyrale, me kujdestarin apo me familjen biresuese, behet njohja dhe afrimi i femijes me familjen dhe prinderit ose të afermit njihen me ecurine e femijes ne shkolle, zhvillimin dhe deshirat e tij.
- Ne rastin kur femija mbaron arsimin 9 vjecar dhe behet gati për të vazhduar shkollën e mesme, ne planin individual të largimit, plani percaktohen edhe hapat që do të kryhen për arsimin e metejshem të femijes, llojin e shkollës që do të ndjeke ne perputhje me deshirat dhe prirjet e femijes. Ne bashkepunim me Ministrine e Arsimit dhe Drejtorite Arsimore Rajonale, behet i mundur ofrimi i një të drejte studimi me burse dhe behet sistemimi i tyre ne konviktet e shkollave të mesme (profesionale).
- Ne rastin kur femija largohet nga institucioni, drejt një jete të pavarur ne planin e se ardhmes perfshihen hapat për strehimin e perkohshem (ne strukturat rinore të administruara nga OJF) si edhe mundesimi i ndjekjes se kurseve të formimit profesionale ne funksion të aftesive personale të femijes dhe mbeshtetja ne gjetjen e një nje pune.

Nga intervistat me grupet e fokusuar me të rinj, rezulton se në institucionet rezidenciale publike, puna me fëmijet për të informuar e ndergjegjsuar mbi risqet që shoqërojnë jetën jashtë institucionit, nuk është gjithmone e mjaftueshme. Kur janë jashtë perkuajesit, përveç problemeve ekonomike dhe emocionale të cilat lidhen me largimin nga ky kujdes në moshe të re, mangesite në informacione e ndergjegjesim në jo pak raste kanë sjelle përfshirjen e tyre, në kryerjen e veprimeve që çulesohen delinkente apo të paligjeshme. Jo pak prej tyre janë edhe viktime të keqberesve me qëllim shfrytëzimin për përfitim.

E.D, pas divorcitet të prinderve, ka jetuar 9 vjet në shtëpinë e fëmijes, Zyber Hallulli. Në moshën 16 vjeç ka filluar shkollën e mesme profesionale dega e ndertimit. Megjithatë është 18 vjeç është akoma në vitin e parë të shkollës së mesme, pasi ecuria e tij në mesime është e dobët. Jeton me 11 djem të tjerë në konviktet e shkollës së mesme të hoteleri turizmit. është nxenes me probleme të sjelljes, herë pas herë është denuar nga stafi pedagogjik i shkollës për thyerje të rregullit në shkollë. Drejtues të konviktit tregojnë se ai në bashkëpunim me shoqe jashtë shkollës, është përfshirë në krimet e vjedhjes dhe veprimeve të dhunshme.

Burimi: Intervista e Drejtuesit të kujdestare të Konviktit Hoteleri Turizëm.

3.5. Shërbimet pas daljes nga përkujdesi

Megjithatë ndryshimet pozitive në drejtim të përkujdesjes për fëmijet, shërbimet e pas përkujdesit nuk janë ende në qendër të vëmendjes të strukturave që hartojnë politika si në nivelin qendror ashtu edhe në atë vendor. Aktualisht nuk ka një ligj specifik për daljen nga përkujdesi dhe pas përkujdesit, lidhur me përgjegjësinë e strukturave qeverisëse (qendrore dhe vendore) në ofrimin e shërbimeve në mbështetje të të rinjve që lenë përkujdesin. Standartet e shërbimeve sociale të ndertuara vitet e fundit, mbulojnë vetëm përkujdesin brenda strukturave të përkujdesjes. Për pasojë ajo që ofrohet sot, është minimale dhe shpesh e pa koordinuar si për moshën 14-18 vjeç dhe atë pas 18 vjeç.. Mungesa e mundësive për strehim dhe punësim ka kthyer pjesën më të madhe të të rinjve që kanë dalë nga përkujdesi, në një grup vulnerabël dhe pa një plan adekuat mbështetës.

Çfarë shërbimesh ju ofrohet aktualisht të rinjve pa kujdes prindëror?

Sistemi publik i shërbimeve sociale (arsimi, mbrojtja sociale, shërbimi shëndetësor, punësimi) nuk ofron një mbështetje të vecantë për të rinjtë që lenë përkujdesin. Në ligjin nr. 9355 datë 10.03.2005, "Për Ndihmën ekonomike dhe përkujdesin i shoqëror", ligjin nr. 8153, datë 31.10.1996, "Mbi statusin e jetimit" dhe ligjin 9382 të vitit 2004, "Për strehimin social", sanksionohet mbrojtja e vecantë dhe vendosen prioritetet të larta në trajtimin me ndihmë ekonomike, bursë studimi, strehim, shërbim shëndetësor, për të rinjtë me status jetimi. Megjithatë kjo mbështetje egziston ligjrisht, realizimi i saj në praktike është pothuajse i pa-zbatueshem për strehimin dhe punësimin. Me përjashtim të ndihmës ekonomike, pjesa më e madhe e shërbimeve pas përkujdesjes, sot realizohen nga OJF që mbështesin të rinj jashtë përkujdesit, kryesisht bazuar në strukturat dhe mjetet financiare të vete OJF.

Theksojmë se ky ligj mbulon nevojat e të rinjve që kanë përfituar statusin e jetimit duke e bërë të pamundur trajtimin dhe plotësimin e nevojave të "jetimëve sociale"

Shërbimet statutores (ligjore) për të rinjtë që kanë përfituar statusin e jetimit.

Bursa. Të rinjtë jetimë që ndjekin skollën e mesme, përfitojnë bursë nga shteti, nëpërmjet Ministrisë së Arsimit. Bursa dhe trajtimi për veshmbathje për vitet e

shkollës se mesme dhe të lartë përcaktohet me vendim të Keshilit të Ministrave. Të rinjtë jetimë, që vazhdojnë shkollën dhe jetojnë në konvikte, gjate periudhës së verës trajtohen me pagese suplementare. Kjo kategori është e lejuar të qëndrojë në konvikte gjatë pushimeve të fundjavës dhe gjatë pushimeve të verës, që rezulton të jetë e dhimbshme për ta duke u krahasuar me konviktorët e tjerë.

Librat e shkollës. Fëmijët jetimë që ndjekin shkollën e mesme, përfitojnë të gjithë librat (tekstet mesimore) dhe mjetet shkollore falas.

Strehim. Fëmijët dhe të rinjtë që ndjekin shkollën e mesme dhe të lartë, përfitojnë strehim në konviktet e shkollës që ata ndjekin ose në një konvikt të një shkolle tjetër. Strehimi i personave që kanë përfituar statusin e jetimit bëhet me përparësi nga shteti, sipas kriteve të përcaktuara në ligjin 8030 datë, 15.11.1995.”Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha“dhe ligjit No. 9382, v. 2004, “Mbi Strehimin Social”.

Ndihma ekonomike. Të gjithë të rinjtë jetimë, pas moshës 18 vjeç, që kanë mbaruar shkollën e mesme ose të lartë, që kanë përfituar statusin e jetimit, përfitojnë ndihmë ekonomike (në masën 3,000 lekë në muaj), deri në zenien e tyre me punë²⁷.

Nuk ka limit moshor për përfitimin e ndihmës ekonomike. Dhënia e kësaj ndihme lidhet me mungesën ose pamjaftueshmërinë e të ardhurave.

Sherbimi shëndetsor, dentar dhe medikamentet, për jetimet që nuk janë në mardhenie pune, sigurohen falas nga shteti.

Transporti dhe levizja. Fëmijët dhe të rinjtë, (me statusin e jetimit) udhëtojnë falas në transportin publik, kur nuk janë në mardhenie pune.

Punesimi, i jetimeve ligjerisht duhet të bëhet me përparësi nga zyrat e punes

4. PROFILI I TË RINJVE OË KANË DALË NGA PËRKUJDESI

4.1 Të dhëna për fëmijët në përkujdesie

Shqipëria megjithëse është një vënd I varfër, ka një numër relativisht të vogël të fëmijëve jashtë kujdesit prindëror në përkujdes shoqëror, krahasuar më vendet e rajonit. Të dhënat nga Social Monitor për vitin 2004, treguesi i numrit të fëmijëve në strukturat rezidenciale të përkujdesjes ishte 62.4 fëmijë për 100,000 popullsi të grupmoshës 0-17 vjeç, krahasuar më 175,5 për Maqedoninë, 795,9 për Bullgarinë, 740.3 për Rumaninë dhe 403.9 për Kroacinë.

Është e vështirë të japësh një informacion numrin dhe profilin e adoleshenteve/të rinjve (15-24 vjeç) përfitues ose ish përfitues të shërbimeve të përkujdesjes, për shkak të fragmentarizimit të shërbimeve në duart e disa aktorëve (institucione publike, shkolla të mesme më konvikte, OJF e familje) dhe mungesës së të dhënave.

Numri i fëmijëve në përkujdesje. Sipas informacionit nga Shërbimit Social Shtetëror, në vitin 2008, në Shqipëri numëroheshin rreth 608 fëmijë jashtë kujdesit prindëror që mbështeten nga sistemi formal i përkujdesit, i përfaqësuar nga institucionet rezidenciale publike (me 241 fëmijë) dhe institucione të vogla rezidenciale apo shtëpi familje, të drejtuara nga sektori joqeveritar më donacione të huaja (me 362 fëmijë).

Kërkesa për transferim nga struktura përkujdesi për fëmijë në struktura rinore. Organizimi aktual i informacionit nuk lejon identifikimin e numrit të fëmijëve që largohen/lëvizin nga institucionet (publike e private) të fëmijëve drejt strukturave rinore apo kthehen në familje biologjike. Megjithatë një vlerësim i shpejtë për 2007,

²⁷ kjo ndodh edhe pas moshës 25 vjeç nese ata nuk kanë marrë strehim ose nuk kanë krijuar familje

tregoi se kerkesat nga institucionet publike të përkujdesit për transferim adoleshentesh (15 vjec +) në struktura rinore të administruara nga OJF, ishte 12 (7 vajza dhe 5 djem).

Gjatë vizitave në terren për realizimin e këtij studimi u identifikuan 103 adoleshente e të rinj që i përkisnin grupmoshes 16-25 vjec. Megjithatë vlerësohet se kjo kategori ka një numer më të larte, pasi nuk janë përfshirë të rinj më aftesi të kufzuar jashtë kujdesit prindror.

4.1.2 Të dhëna për të rinjtë që janë larguar nga përkujdesi

Situata aktuale	Numri	Grupmosha
Përfitues	900	(mbi 18)
Ndihmë ekonomike (3000 lek/muaj)	356	(18 -25 vjec)
Papunësia/ Të papunë	217	(mbi 25 vjec)
Me strehim	29	-

Burimi i informacionit : Shërbimi Social Shtetëror, 2007

4.1.3 Të dhëna nga të rinjtë të intervistuar të larguar nga përkujdesi

Në këtë seksion, informacioni mbi profilin e adoleshenteve/të rinjve vjen nga intervistat e kryera për qellimin e këtij studimi më 47 të rinj 15-24 vjeç, më histori përkujdesi në struktura rezidenciale dhe shtëpi familje (Intervista zhvilluar pranë Zyber Hallulli, Konvikti Hoteleri Turizëm, Tiranë, Konvikti Safet Spahiu, Maddonina Del Grappa Shkodër, Shtëpia e Shpresës dhe Tjetër Vizion, Elbasan, Konvikti i Ish Rezervave Tiranë, SOS Fshatrat e Fëmijëve)

- 62 % i përkasin grup moshës 15-18 vjeç dhe 38 % grupmoshës 19 -24 vjeç
- 57 % janë vajza
- 68 % kanë kryer vetëm arsimin e detyruar, 26 % vazhdojnë të mesmen apo kanë kryer atë, ndërsa 6 përqind ndjekin një shkollë të larte
- 13 % - jetime biologjike
- 10 % - minoritete Roma/Evgjit
- 20 % - vijnë nga zonat urbane
- Asnjë i dianostikuar më HIV AIDs

5. VËSHTRIM PËR TË DREJTAT E TË RINJVE PA KUJDES PRINDËROR

5.1 Të drejtat e dhunuara të të rinjeve që largohen nga përkujdesi

Të rinjte që lënë përkujdesin kanë disavantazhe të shumëfishta për të filluar një jetë të pavarur në krahasim më bashkëmoshataret e tyre qe jetojne në familje. Evidencat dhe eskperienat e tyre tregojne se lloji i përkujdesjes dhe mbështetja gjatë dhë pas lënies së përkujdesit, luajne nje rol të rëndesishem në rezultatet e arritjve të tyre. Të rinjte më histori përkujdesi nga institucionet rezidenciale publike, manifestojnë edhe fomat më të këqia të rezultateve kur ata shpëputen nga përkujdesi: ata përjetojnë varfëri afatgjatë, izolim social, shëndet të dobët, në jo pak raste janë përdorues të rregullt substancash të ndaluara, janë të pastrehe, të

papunë afatagjatë, kanë një nivel të ulët shkollimi, dhe janë në risk të lartë për tu përfshirë në aktivitete jo të ligjshme, apo për të qenë i abuzuar nga keqbërës e trafikantë.

Historia e A (aktualisht në konvikt):

Jam 20 vjeçe dhe aktualisht banoj në konviktin e shkollës së mesme që kam mbaruar 2 vjet më parë. Më thonë që do të më heqin, dhe jam e tmerruar se s'kam ku të shkoj. Babain e kam gjallë dhe jeton në një fshat të B. Bashkimi më të pas 10 vjetësh që unë kam qëndruar në institucion, është e vështirë dhe e pashpresë. Megjithëse kam mbaruar shkollën e mesme si teknologe ushqimore dhe kam kryer edhe një kurs kualifikimi profesional për rrobaqepsi, nuk kam mundur të gjej një punë. E kam të vështirë të gjej punë. Jeta jonë ndryshon nga ajo e të rinjve të tjerë që kanë jetuar në familje. Megjithëse kam shoqëri dhe shokë dhe shoqe të jetimorë, ata nuk mund të më ndihmojnë, pasi ndajnë të njëjtat probleme e vështirësi si unë. Ndihem shpesh e shpërfillur dhe e mëshiruar. Dëgjoj shpesh të më thonë "ja gjynah e shtëpisë së fëmijës". Këtu në konvikt shihemi ndryshe nga ata që vazhdojnë shkollën. më ndihmën ekonomike prej 3,000 lek në muaj, nuk plotësoj as nevojat për bukë. Për të marrë në certifikatë në gjëndjen civile, më duhet të paguaj njëhere taksën e pastrimit, ndërsa kur kam nevojë të vizitohen.....tregoj se s'mund të paguaj se jam e papunë dhe nga shtëpia e fëmijës. A duhet unë të përjashtohem nga taksat apo të mos paguaj për vizitat mjekesore, deri sa të rregullohen më punë? Them se po.

Burimi: Intervistat me të rinjtë jashtë përkujdesjes

5.2 Shkaqet kryesore të dhunimit të të drejtave

Së pari: Varferia është edhe ndër shkaktarët kryesorë që prindërit shikojnë strukturat e përkujdesit si një alternativë për vendosjen e fëmijëve të tyre. Numri në rritje i fëmijëve jashtë kujdesit prindëror nga familjet e varfëra të zonave rurale, tregon se varfëria e cila nuk adresohet efektivisht më punësim dhe programi i mbrojtjes më të ardhura të familjeve të varfëra (ndihma ekonomike) po privon në mënyrë të panevojshme kujdesin prindëror, të një numri gjithnjë e më të madh fëmijësh.

Së dyti: Trafikimi dhe abuzimi më të rinjtë më histori përkujdesi është i lartë kryesisht tek femrat. Varfëria dhe mungesa e shërbimeve mbrojtëse e mbështetëse rrit vulnerabilitetin e femrave dhe i kthen në viktime lehtësisht të arritshme për trafikantët dhe abuzuesit.

Së treti: Forma rezidenciale e përkujdesjes, kryesisht në strukturat publike, më një numër të madh fëmijësh dhe ndërrim të shpeshtë të përkujdesit nga një institucion në tjetrin, ndikon negativisht në zhvillimin emocional, fizik dhe fëmimin e tyre. Ata manifestojnë probleme të zhvillimit, janë rebele dhe në shume raste jo të disiplinuar. Këto tipare ju vështirojnë integrimin në jetën normale, krijimin e miqësive e shoqërive, mbarëvajtjen në shkollë dhe punë.

Së katërti: largimi nga institucionet e përkujdesjes (kryesisht ato publike) në moshë të re (15 vjeç) dhe mos mbështetja e mbikqyrja e mëtëjshme nga shumë aktorë e struktura që kanë ose duhet të marrin përgjegjësi. Edhe pse për fëmijët jashtë kujdesit prindëror ndërtohet "Plani im për të të ardhmen" për zbatimin e cilit kërkohet angazhimi i shumë aktoreve, përgatitja e tij në mënyrë të njëanëshme nga vetë institucionet dhe pa pjesëmarrjen e konsultimin e të gjithë aktorëve

kontribues, çon që “Plani” të mbetet në pjesën më të madhe vetëm në leter, duke mos gjetur zbatim të mëtjshëm në momentin që të rinjtë janë jashtë përkujdesjes.

Së pesti, mungesa e ndërjegjësimit të ofruesve të shërbimeve mbi të drejtat e fëmijëve jashtë kujdesit prindëror dhe mungesa e një akti ligjor që rregullon procesin e lënies së përkujdesit dhe mbështetjes, çon në moskordinimin e veprimeve ndërmjet strukturave publike që ofrojnë shërbime (kryesisht të strehimit dhe punësimit) dhe strukturave të përkujdesjes. Mosmbështetja më strehim dhe punësim gjatë lënies së përkujdesitqë më pas rrit marginalitetin jo vetëm të kategorive që dalin nga përkujdesi residential por edhe atë të tipit shtëpi-familje.

Së gjashti, kultura paragjyqese dhe rritja e indiferencës së shoqërisë ndaj shumë fenomeneve sociale. Vështirësitë e të rinjeve që kanë lënë përkujdesin shtohen edhe nga stigma që shoqëria ka për kategorinë e personave më histori përkujdesi. *Një pjesë I konsideron si të “gatuar keq” e që asgjë nuk i ndryshon; si njerëz më vese, dembelë dhe me moral të dobët. Të tjerë janë indiferentë e neglizhues në mardhëniet më ta.*

Në informacionin e mëposhtëm, të dhënat vijnë kryesisht nga historitë personale të rinjve më histori përkujdesi në sistemin. Gjithashtu edhe eksperiencat e të rinjeve që vijnë nga përkujdesi në struktura të shtëpi -familje janë gjithashtu pjesë e informacionit. Megjithatë për këtë pjesë programet e përgatitjes për lënie e përkujdesit janë ende në vitet e para të eksperimentimit.

5.1 MOSDISKRIMINIMI

Stigmatizimi

Të gjithë të rinjtë e intervistuar raportuan që vuajnë nga stigma dhe përjashtimi social.

Të rinjtë me histori përkujdesi janë në risk të lartë për të vuajtur diskriminimin jo vetëm të bashkëmoshatareve të tyre dhe shoqërisë në tërësi, por edhe të strukturave publike. Ata paragjyqohen, përçmohen dhe neglizhohen jo rrallë dhe më dashje nga strukturat e punësimit dhe strehimit.

“Drejtuesit e konviktit nuk na duan. Na kërcënojnë çdo ditë se do të na nxjerrim jashtë, pasi qëndrimi në konvikt është jo i rregullt. As ne duam të rrimë, por s’kemi ku të shkojmë. Na ndihmojnë me ushqimin dhe lejohe mi të hamë, në fund të vakteve të ngrënies së nxënësve konviktore »

(Fokus grup me të rinjtë në konviktin Hoteleri Turizëm, Tiranë).

Të rinjtë e intervistuar treguan se jo rrallë janë objekt fyerjesh, diskriminimi në punë apo e një “vëmëndjeje” të tepruar. Këto eksperiencat ju krijojnë stres dhe në jo pak raste i kanë detyruar të lënë punën.

Punëdhënësi im ishte gjithnjë me nerva me mua. Më fyente e më përgjigjej rënde pa ndonje shkak të rëndësishëm. Edhe nga shoqet e punës, nuk kisha ndonje perkrashje. më shihnin ndryshe dhe nuk më benin shoqerë. Për ne nuk kanë opinion të mirë. Nuk munda ta përballoja edhe pse kam nevojë të punoj. Ndihem e lodhur dhe s’mund të duroj që të më fyejnë, përbuzin apo mëshirojnë. E lashë punën, përpara se të bëja ndonjë marrëzi (te rrihja ndonjerën).”

(Një vajzë 19 vjeçe nga Shkodra).

Ndihem keq sepse të tjerët shpesh më përmendin faktin që unë jam rritur në një institucion përkujdesi. Në shumë raste nuk lejohe mi që të jem pjesë e shoqërisë së tyre.

(Djalë, 15 vjeç, Zyber Hallulli)

Format e diskriminimit janë disa here negative e disa herë pozitive, por jo të preferuara nga të rinjtë sepse i vendosin ata në qëndër të vëmendjes të të tjerëve.

Mesuesja tregon një vëmendje dhe përkrahje të tepruar ndaj meje, sepse unë jam nga SOS. Por mua kjo nuk më pëlqen sepse dua që të ndihem e barabarte me të tjerët.

(një vajzë 17 vjecare nga SOS).

Shkaqet e shkeljes së të drejtave

- I. Perceptime dhe paragjykime kulturore për të rinjtë si individë që i përkasin një grupi të caktuar, përgjithësisht të varfër, të pamundur për tu integruar, që i përkasin një "institucionit", me arsim të ulët dhe me probleme të sjelljes.
- II. Meshirimi apo mosperfillja si qëndrime shoqërore
- III. Mungesa e informacionit dhe e ndërgjegjësimit mbi problemet me të cilat përballen të rinjtë që lënë përkujdesin.

Përfundim nga integrimi social

Të rinjtë që lënë përkujdesin vuajnë një nivel të ulët të integritit në shoqëri. Këto forma fillojnë në stadi të para të jetës dhe i shoqërojnë si gjatë kohës në përkujdesje, ashtu edhe pas saj.

Gjithmonë hamë vec nga konviktorët e tjerë dhe kjo nuk është e drejtë. Përse duhet të veçohemi në këtë mënyrë

(një vajzë 20 vjecare që jeton në konvikt, Tiranë)

Edhe kur ndonjëherë grindemi me ndonjërin nga shokët e klasës, shprehen për ne "mos u merrni më ta. Ata vijnë nga SOS dhe sillen gjithmonë kështu" ... Çfare të bëjmë, jemi të mësuar tashmë me këtë opinion.

(një i ri, 18 vjeç SOS)

Shkaqet e shkeljes së të drejtave

- I. Strukturat përkujdesjes të ndërtuara në zona periferike urbane, ndikojnë negativisht në integrimin social dhe shkaktojnë izolim social dhe psikologjik brënda "ishullit/strukturave që ofrojnë përkujdesje.
- II. Politikat dhe praktikat diskriminuese të ndjekura ndonjëherë në vendet ku ata jetojnë, p.sh në konvikte.
- III. Praktika të varfra që promovojnë dhe inkurajojnë integrimin e tyre social në shoqëri
- IV. Perceptime social kulturore stigmatizuese drejt të rinjve pa kujdes prindëror

5.2. E DREJTA PËR ARSIM

Fëmijet në përkujdes manifestojnë probleme të mesim-nxënies. Për pasojë pjesa më e madhe ka nivel të ulët arsimor dhe nuk mundet të shkollohet më tej se arsimi i detyruar. Rreth 60 përqind të intervistuarve kishin kryer ose kishin dashur të kryenin vetëm arsimin e detyruar. Në krahasim me moshataret e tyre ata mbajnë një nivel më të ulët arsimor. Me të riskuar janë fëmijet më historikisht përkujdesi residencial.

"Fëmijet në institucionin tone kanë prapambetje mendore dhe teste të kryera e tregojnë këtë prapambetje. Pjesa më e madhe e tyre mezi mbaron arsimin e detyruar, por ne shpeshherë i dërgojmë në shkolle të mesme më qellim që t'ua zgjasim strehimin dhe ushqimin." –pohojnë punonjës së Shtëpisë e Femijes, 6-15, Tiranë..

Për ata që dalin me rezultate të mira në arsimin e detyruar dhe duan që të vazhdojnë arsimin e mesëm, zgjedhja e profilit nuk bëhet sipas profilit/degës që ata pëlqejnë, por është e kondicionuar më zgjedhjen e një shkolle që ka konvikt më qellim sigurimin e një strehe edhe për disa vite.

Heqja e së drejtës për të vazhduar shkollën kur moshë biologjike është më e madhe se ajo shkollë.: Disa nga fëmijët që dërgohen në institucionet e perkudësimit kanë një moshë biologjike më të madhe se ajo shkollë. Në këtë rast, regjistrimi në arsimin e mesëm mbi moshën 16 vjeç, është pothuajse e pamundur. Shumë prej këtyre fëmijëve janë përsëritës ose për arsye të ndryshme kanë patur ndërpreje të shkollës. Këto kategori nuk mund të regjistrohen në shkollën e mesme. Edhe në rast se realizohet, ajo bëhet me ndërhyrje miqësore. Këtë e vuajne më shumë fëmijët e etnisë Roma

Shkaqet e shkeljes së të drejtave

- I. Nivel i ulët i mesimit nxënies, për shkak të formës rezidenciale të perkudësimit, e kombinuar me punën e dobët në shkollë, mos-komunikimi i efektshëm ndërmjet shkollës dhe kujdestarëve si edhe mbështetje e pamjaftueshme e kujdestarit /punonjësit social dhe mesuesit në shkollë, con në rezultateve të ulta në shkollë dhe në pamundësi për të perballuar shkollën e mesme.
- II. Kjo deficienca nuk adresohet drejt si nga shkolla ashtu edhe nga strukturat e perkudësimit me qëllim kapercimin e saj. Mungesa e kualifikimeve të stafëve që adresojnë nevojat për edukim i kombinuar edhe me faktore të diskriminimit në raste të rralla.
- III. Mungesa apo mos adresimi në shkollë i nevojave të vecanta për fëmijët me prapambetje të lehtë mendore.
- IV. Lënia e perkudësimit në moshë të hershme pa suport të mëtjshëm
- V. Mungesa e rritjes së motivacionit të të rinjve për rëndësinë e arsimit dhe edukimit për të ardhmen e tyre.
- VI. Regjistrimi në shkollën e mesme për fëmijët në perkudës, gjithashtu vështirësohet nga legjislacioni aktual mbi arsimin publik. Ministria e Arsimit Publik ka ndërmarrë një inisiativë për korrigjimin e këtij handicapi, nëpërmjet realizimit të një programi shkollor që quhet Shansi i Dytë. Ky program ka si target fëmijët që punojnë apo kanë probleme të gjakmarrjes. Nuk ka informacion nëse do të përfshihen edhe fëmijët në perkudës që kanë një moshë më të madhe se ajo shkollë.
- VII. Marrja e “ përgjegjësive prindërore” dhe shndërrimi në të “rritur” në moshën në moshë të hershme, për shkak të perceptimit të të ardhmes si të pashpresë dhe pa mbështetje nga dikush.

Më duhet të mos vazhdoj shkollën e mesme, më duhet të punoj. I kam premtuar nënës (që ka vdekur) se do kujdesem për motrat e mia deri në momentin që do të martohen –

(Vajze 16 vjece nga Madonnina del Grappa- Shkoder.

5.3. E DREJTA PËR PUNËSIM

Gjatë intervistave me të rinj me histori perkudësi rezidencial, rreth 2/3 e tyre deklaruan se ishin të papunë, ndërsa ata që ishin të punësuar, kishin një punë, jo stabil dhe jo formale dhe të ardhurat e gjeneruara prej saj të pamjaftueshme për të jetuar

Papunësia është njelloj e lartë tek të dy seksjet. Për ata që punojnë, punët e kryera apo punësimi aktual ishte në fabrike si punetore, në shërbime si kamariere, pasticierë apo punonjëse pastrimi.

Rreth 90 përqind e të intervistuarëve, raportuan se kishin ndjekur kurse profesionale. Për jo të gjithë, ndjekja e një kursi profesional përputhej më interesin e tyre apo me kërkesën në tregun e punës. Pjesa më e madhe e tyre nuk janë të orientuar rreth nevojave të tregut të punës dhe mungojnë shërbimet e këshillimit të karrierës profesionale.

Unë nuk di se si të shkruaj një CV.....Nuk ka punë ku të gjesh apo kërkosh.....Mundohem të gjej punë më anë të gazetës, por është e vështirë –Djalë, 17 vjeç, OJF)

Shkaqet e shkeljes se të drejtave

- I. Niveli i ulët i arsimimit për një pjesë të konsiderueshme të të rinjve, ndikon negativisht në gjetjen e punësimit
- II. Të gjithë të intervistuarit që nuk ndiqnin shkollën (që e kishin lënë apo nuk e kishin përfunduar atë) raportuan se i janë drejtuar Zyrës së Punësimit (zyrë pranë Autoritetit Lokal) por nuk kishin marrë mbështetje.
- III. Nivel i ulët i aktivitetit të Zyrës së Punësimit për plotësimin e nevojave për punësim të të rinjve.
- IV. Mungesa e informacioni për natyrën multidimensionale të nevojave dhe problemeve që kanë të rinjtë pa kujdes prindëror dhe mostrajtimi i tyre me prioritet
- V. Programet aktuale të punësimit nuk kanë qenë aktualisht aktive për këtë grup. Asnjë nga të intervistuarit nuk ishte përfitues i politikave aktuale të punësimit (bizneseve, dhe punësimeve me kohë të plotë ose të pjesshem)
- VI. Moszbatimi i ligjit “Për statusin e jetimit” ku punësimi i kësaj kategori përbën prioritet.
- VII. Gjithashtu, edhe si rezultat i shkallës së lartë të papunësisë për të rinjtë shqiptarë.

5.4. E DREJTA PËR STREHIM

Shumë e të rinj që lënë përkujdesin e kanë shumë të vështirë të përballojnë strehimin kur dalin të pavarur. Një pjesë e mirë nuk ka mundësi e kthehet në familje dhe mungesa e një alternative strehimi nga strukturat shtetërore dhe pamundësia e tyre për të përballuar vetë një banesë më qera e kthen pjesën më të madhe të tyre në të pastrehe. Pjesa më e madhe e tyre jetojnë në konviktet e shkollave të mesme dhe disa gjithashtu formojne familje qe gjithashtu mund të jetojë në të njëjtën strukturë. Një pjesë prej tyre strehohet në struktura publike të abandonuara e të rrënuara.

E.l 22 vjeç, i abandonuar nga lindja dhe i rritur nstruktore publike perkujdesi, jeton në një bodrum pa dritare në shkallet e stadiumit të Shkodrës, ndërsa Gezimi 21 vjeç në një kasolle të abandonuar – Raport i Amnesty International report , 2007

“ Të paktën shteti duhet të na jap një vend ku të jetojmë....qoftë edhe një barrakë....ne nuk mund të jetojmë gjithë jetën në konvikte” – Fokus grup vajzash, Konvikti Shkodër.

Konditat e banimit në konvikte janë të veshtira, vecanerisht për grupmoshën 15 deri 18 vjeç. Ambientet ku jetojne të janë mbipopulluara dhe me kushte higjeno sanitare të keqia.

Në 2005, Qeveria shqiptare ndërtoi një program për ndertimin deri në 2010 të 4,000 banesave sociale për strehimin e grupeve të varfëra dhe të pastreha. Deri tani zbatimi i këtij programi ka një progres të ngadalshëm. Gjithashtu disa bashki kanë programe për strehimin social. Megjithate shumë pak të rinj më histori përkujdesi e të pastrehe kanë përfituar prej tyre. (Raporti i Amnesty International, 2007).

... Mungesa e mbështetjes nga pushteti lokal me banesa popullore apo mundesi strehimi, na ka krijuar një problem të madh thoeë Diana–kujdestare shtëpisë familje-Shkodër. Ne nuk kemi fonde të mjaftueshme për të blerë shtëpi të reja apo për të

marrë ambiente tjera me qera, me qellim strehimin një numri më të madh adoleshentesh/ rinjsh. Kjo na ka detyruar që të refuzojmë këtë vit, 6 kërkesa të reja për raste të rinjsh që janë larguar nga institucioni rezidencial këtu në Shkodër dhe 2 kërkesa për përkujdesje nga familjet.

“Lista e personave për strehim është shumë e gjatë. Secili përbën prioritet...” – Përfaqësues i Bashkisë Shkodër

Shkaqet e shkeljes së të drejtave

- I. Mungesa e angazhimit serioz në strukturave të Qeverisjes vendore dhe Qendrore në adresimin e e strehimit më prioritet të të rinjve që largohen nga përkujdesi.
- II. Lidhje e dobët ndërmjet të rinjeve jashte përkujdesit të pastrehë dhe shoqatave lokale të Jetimeve, më qellim bashkëpunimin për informimin dhe aplikimin në kohë për strehim, pranë strukturave përgjegjëse
- III. Moszbatimi i ligjit për statusin e jetimit, për ata që e gëzojnë këtë status, ku strehimi përbën prioritet
- IV. Mungesa e nje legjislacioni për mbështetjen e Jetimeve sociale me strehim.
- V. Mungesa e vendimeve për shqyrtimin dhe përfitimin e trashëgimisë financiare për të rinjte me histori përkujdesi, që nuk e kanë humbur kujdestarinë e prindërve, por që prindërit nuk përmbushim detyrimet e tyre.
- VI. Inisiativat në nivel qeverie vendore, mbi strehimin social të kategorive në nevojë, janë ende të pazhvilluara ose në stade fillestare

5.5. MBROJTJA SOCIALE

Për të rinjte me histori rezidenciale përkujdesi, procesi i lënies së përkujdesit dhe pas tij, është më i pa gjeturi dhe i mbuluar fare dobët me shërbime që mbështesin përgatitjen për daljen në jete të pavarur. Te rinjte me histori përkujdesi, kur mbushin moshën 18 vjeç, cilësohen si përfitues të një ndihmë mujore ekonomike të një niveli prej 3,000 lek në muaj në rast se janë të papunë dhe nuk vazhdojnë shkollën. Vlera është e pamjaftueshme për të mbuluar nevojat bazë të mbijetesës dhe praktikisht ata jetojnë në varferi extreme.

Shkaqet e shkeljes së të drejtave

- I. Mungesa e angazhimit serioz në adresimin e nevojave më jetike të të rinjve që lënë përkujdesin, mos-koordinimi ndërmjet aktoreve në nivel lokal, përgjegjës për mirëqënien e tyre
- II. Hartimi i planeve të largimit nga përkujdesja që realizohet nga stafi i institucioneve të përkujdesit nuk mbështetet e zbatohet edhe nga hallkat e tjera, që duhet të ofrojnë përkujdesje të mëtejshme si p.sh. zyra e strehimit, zyrat e punes, punonjesi social i konviktit, mjeku i familjes, etj.
- III. Nuk ka një akt ligjor që rregullon dhe mbështet daljen nga përkujdesi të të rinjve. Ligji mbi Statusin e Jetimit, adreson nevojat e nje pjese të vogel të e rinjeve më histori përkujdesi. Ndërkohë që zbatimi i Statusit të Jetimit pothuajse nuk realizohet në drejtim të punësimit dhe strehimit.
- IV. Niveli i ulët i ndihmës ekonomike dhe mos percaktimi i vlerës se saj mbi bazën e nevojave minimale.
- V. Mungesa e financimeve për mbështetjen e nevojave të të rinjeve që lënë përkujdesin (e justifikuar edhe më mos ndryshimin e ligjeve dhe politikave për këtë kategori)

5.6. MBROJTJA NGA ABUZIMI DHE FORMAT E TJERA TË SHFRYTËZIMIT

Adoleshentet e të rinjte më histori përkujdesi janë në risk të lartë për të qënë viktimat të trafikantëve apo për tu shfrytëzuar nga punëdhënësit, ku në jo pak raste i paguajnë pak dhe nuk bëjnë sigurimin e tyre tek sigurimet shoërore.

Vajzat janë edhe viktimat potenciale të krimit të përdhunimi, trafikimit dhe përfshirjes në prostitucion. Ndonëse në konvikte ka kujdestare, gjatë fundjavës apo pushimeve të verës vajzat raportojn frike në lidhje me mbrojtjen e tyre. Disa vite më parë kishin ndodhur raste përdhunimesh apo edhe rrëmbimesh me qëllim trafikimin. Në 2006 një stacion televiziv në emisionin "Në kërkim të njerëzve të humbur" publikoi rastet e 11 vajzave jetime (me histori përkujdesi), të zhdukura gjate 10 vjeteve të fundit. Njëra prej tyre rezultoi e zhdukur bashkë me fëmijën 18 muajsh.

Në rast se mund tju pyesja unë ju- i drejtohet intervistuesit, një vajze 17 vjece nga konvikti, Shkoder -....Kur s'keni para, punësim apo dikë që ju ndihmon, çfarë do të bënit ju për të mbijetuar....do të provonit të përdornit çdo mënyre, apo jo?

Shërbimi Social Shtetëror nuk ka të dhëna mbi numrin e jetimëve mbi 14 vjece (me histori përkujdesi) që jetojnë në konvikte, se sa prej tyre janë viktimat të trafikimit për qëllim prostituimi, se sa kanë kryer krimin e vjedhjes, etj. Askush nuk di gjë për situatën e tyre – thotë Drejtori Ekzekutiv i Institutit për Integrimin e Jetimëve²⁸

Shkaqet e shkeljes së të drejtave

- I. Mungesa e struktura për të rinjtë për ti mbështetur ata sistematikisht me shërbime profesionale dhe për të adresuar nevojat e tyre. Mungesa e shërbimeve veçanërisht për grupmoshën 14-18 vjeç të cilët janë në një fazë delikate të zhvillimit, mosha e adoleshencës
- II. Indiferenca e strukturave të përkujdesit dhe e komunitetit ndaj problemeve dhe risqeve më të cilat përballen të rinjtë që lënë përkujdesin
- III. Niveli i ulët i besimit nga të rinjtë në rolin e shtetit lidhur me çështjet e tyre, veçanërisht departamenteve të policisë.
- IV. Kapaciteti i ulët i qeverisë vendore në adresimin e problemeve e të rinjve që lënë përkujdesin.
- V. Niveli i lartë i papunësisë dhe niveli ulët i shkollimit të të rinjve që lënë përkujdesin.
- VI. Pamjaftueshmëria e goditjes së shtetit ndaj trafikantëve të qenieve njerëzore

Sjelljet delikvente

Gjate intervistave të rinjte qe kishin lene perkujdesin, raportuan edhe raste të përfshirjes në veprime të delinkuencës si zënie/rrahje apo vjedhje në treg. Trajtimi i tyre nga sistemi i drejtësisë në rast se kryejne veprime në kundërshtim me ligjin është i njëjti më atë të bashkemoshatareve të tjere. Nuk ka raportime mbi numrin e përsëritësve të krimit nga kategoria e të rinjve qe kane lene perkujdesin. Djemtë më shumë përfshihen në vjedhje dhe trafik droge.

Në rast se kjo ndodh, nuk egzistojne sherbime të specializuar rehabilitimi.

"Zihen shumë- thote drejtorja e konviktit Shkodër, ku janë strehuar 9 vajza jetime - Rrihen e bërtasi. Sa disa herë kam thirrur policine për ti qetësuar e trembur që të mos e përsërisin. Ngacmojnë konviktoret dhe "gjuajnë" ato më të urtat për të përfituar prej tyre, ushqim, lekë apo veshje".

Shkaqet e shkeljes së të drejtave

- I. Mungesa e strukturave të rehabilitimit pas denimit (edukim, punësim)
- II. Vuajtja nga "institucionalizimi" dhe si rrjedhojë nga marxhinalizimi dhe përjashtimi nga shoqëria.

²⁸ Adult orphans and the right for housing; Amnesty International Report, 2007

- III. Mungesa e mbështetjes dhe e mbikqyrjes profesionale në adresimin e sjelljeve me risk.
- IV. Një sistem ligjor jo efektiv lidhur me krimet e shkallës së parë, të kryera nga të miturit apo të rinjte dhe mungesa e një gjykate për të miturit

INFORMIMI PËR SUBSTANCAT E DËMSHME

Të rinjtë e intervistuar kanë informacion mbi substancat dhe sjelljet e dëmshme të marra në shkolle por edhe gjate kohës në përkujdes. Megjithatë vështiresite dhe rrethanat më të cilat ndeshen pas daljes nga përkujdesi, shtyjnë një pjesë për të qënë përdorues të drogës dhe alkolit.

Nuk dihet më saktësi se sa janë përdorues droge, por më të riskuara janë vajzat që mendohet se ushtrojnë prostitucionin, si mjet jetese. Pirja e duhanit është e shpeshtë tk të dy gjinitë, ndërsa për djemte gjithashtu edhe përdorimi i alkolit

Në këtë konvikt, të rinjtë jetime strehohen në katin e parë. Ata pijnë shumë duhan dhe alkol –pohon nje kujdestar konvikti.

Shkaqet e shkeljes së të drejtave

- I. Margjinalizimi/përjashtimi nga shoqëria dhe mungesa e shërbimeve miqësore për të rinjtë apo të qendrave rinore/klube rinore që adresojne nevojat e të rinjeve rreth problemeve të ndryshme.
- II. Mungesa e mbështetjes dhe e mbikqyrjes profesionale në adresimin e sjelljeve me risk
- III. Mungesa e programeve informative, këshilluese dhe e programeve terapeutike për të rinjtë

5.7. E DREJTA PËR MBËSHTETJE

Kur adoleshentet jashtë kujdesit prinderor arrijne moshën për të dale nga institucionet e përkujdesit (publik apo të administruara nga OJF), në më të shumten e rasteve, ata konsiderohen si të rritur që nuk kane më nevojë për tu mbështetur nga sistemi i përkujdesit. Por ndërsa bashkëmoshataret e tyre që jetojnë në familje, vazhdojnë të marrin përkujdesje dhe ndihme nga prinderit edhe për shumë kohë pertej kesaj moshe, institucionet publike të përkujdesit "heqin" dorë shumë heret dhe nuk i mbështesin apo i mbikqyrin më, pas moshës 15 vjec. Në momente të vështira të jetës kur ata kanë më shumë se kurrë nevojë për mbështetje, ata ndien të abandonuar nga ai sistem që i përkujdes. Shumë prej tyre mbesin qëllimisht në klasë për të vonuar daljen nga institucioni apo mbarimin e shkollës së mesme.

“Gjatë shkollës se mesme kam ngelur qëllimisht në një vit, që të mund të zgjasja qëndrimin në konvikt dhe marjen e bursës edhe për një vit tjetër. Nuk kisha ku të shkoja dhe më çfare të jetoja. Nuk zgjidha ndonje gjë të madhe, por e shtyva edhe një vit më shpresën se mund edhe të gjeja ndonjë punë”- thote nje vajze nga konvikti, Shkoder.

Shkaqet e shkeljes së të drejtave

- I. Dalja nga përkujdesi në një moshe shumë të hershme, 15 vjec, kur janë ende të papërgatitur nga pikpamja psikologjike dhe zhvillimore për të qene të pavarur
- II. Mungesa e nje ligji mbi daljen nga përkujdesi (Leaving Care act) që përcakton struktura dhe shërbime mbështetese për të rinjtë në proces daljeje nga përkujdesi e më pas.
- III. Aplikimi nga institucionet e përkujdesjes i procedures se “duhet nxjerre jashte” pa siguruar lidhjet e duhura me aktoret e tjere dhe pa ditur se ku do ti çojne të rinjte qe lenë përkujdesin

IV. Mungesa e komuniteteve rinore dhe qendrave të emergjencës.

5.8.E DREJTA PËR KUJDES SHËNDETSOR

Duke qënë të papunë ose në punësim informal, të rinjtë që kanë lënë përkujdesin, janë të pasiguruar kundrejt përfitimit të shërbimeve shëndetësore pa pagesë në sistemin publik të shëndetit parësor, atij të specializuar (vizitat e specilisteve) dhe spitalor. Në jo pak raste vizitat, kryerja e ndonjë analize apo blerja e ilaçeve, nuk kryhet për shkak të mungesës së të ardhurave.

Shërbimi dentar në Shqipëri është privat dhe kurimi i kushtueshëm dhe i pa përballueshëm për individë me të ardhura të ulta, në të cilën bëjnë pjesë edhe të rinjtë që kanë lënë përkujdesin.

Megjithëse është shumë e vështirë, unë kam mundur të heq para mënjane, për ndonjë ditë të vështirë.....ndoshta kur të sëmuren ndonjëhere.....kush do të më ndihmojë.

Nje vajze 24 vjecare që jeton në konwikt, Shkodër.

Pjesa më e madhe e të rinjeve të kontaktuar gjatë intervistave, pohuan se nuk përfitojnë shërbime shëndetësore, informim apo këshillim, rreth shëndetit riprodhues.

Shkaqet e shkeljes së të drejtave

- I. Marrja e shërbimeve shëndetsore falas vetëm për të siguruarit, rëndon ekonomikisht pjesën e varfër e të pasiguruar, për të paguar për cdo shërbim të marrë.
 - II. Mungesa e alternativave të shërbimit dentar falas, për shtresat e varfëra
 - III. Mungesa e strukturave shëndetësore për këshillimin dhe mbështetjen e të rinjve përsa i përket çështjeve të shëndetit riprodhues
 - IV. Moszbatimi i ligjit mbi Statusin e Jetimit, lidhur me përfitimin falas të shërbimeve shëndetësore për kategorinë e të rinjeve që gëzojnë statusin e jetimit
- V. Sipas Strategjisë së Mbrojtjes nga HIV/AIDS (2005-2010) pjesa më e madhe e vajzave jetimeve kanë tendencën për të braktisur shkollën dhe si pasojë kanë më pak mundësi për tu informuar për çështjet e shëndetit riprodhues dhe si rrjedhojë janë më në rrezik në jetën e tyre më vonë.

5.9. INTERESI MË I LARTË I FËMIJËVE

Në më të shumtën e rasteve, zgjidhjet e dhëna nga strukturat e shërbimeve publike nuk bazohen në respektimin e interesit më të lartë të femijes.

Përkujdesja në qendrat rezidenciale të mëdha dhe largimi i femijeve në moshën 15 vjeç nga kjo përkujdesje, nuk respekton interesin më të mirë të femijes, po ja nënshtron fatin e tyre një modeli më ndikim negativ për të ardhmen. Fëmijët ekspozohen ndaj shumë risqeve që në moshë të hershme, kur ata janë të papërgatitur dhe më shumë nevoja për mbështetje.

Shkaqet për shkeljen e të drejtave

- I. Pamjaftueshmëria e formave alternative të përkujdesjes dhe dominimi i formës rezidenciale .
- II. Përgatitja për jetesë të pavarur për një kohë të shkurtër dhe largimi nga përkujdesja në moshë të hershme.
- III. Pamjaftueshmëri financiare për zhvillimin e formave alternative të përkujdesjes për fëmijë dhe të rinj.

5.10. E DREJTA PËR NJË NIVEL JETESE TË PRANUESHËM

Adoleshentet e të rinjte më histori përkujdesi rezidencial jetojnë në varferi, janë të pastrehë dhe vuajnë papunësinë. Pjesa më e madhe e tyre, do ta vazhdoje jetën në varferi dhe të përjashtuar.

Nuk ka të dhëna mbi numrin e vetëvrasjeve, të vdekjeve për shkak të emigrimit në mënyre të paligjeshme apo të jetegjatësise për këtë kategori. Megjithatë të jetuarit në marginalitet për një kohë të gjatë, rrit riskun për vetëvrasje e vdekje të parakohshme.

Shkaqet e shkeljes së të drejtave

- I. Mungesa e angazhimit serioz në adresimin e nevojave më jetike për të rinjte që lënë përkujdesin
- II. Mungesa e nje informacioni mbi natyrën shumë-dimensionale të nevojave e tyre dhe të renditjes si grup prioritar në mbulimin më shërbime
- III. Mos-koordinimi ndërmjet aktorëve në nivel lokal dhe qendror, si përgjegjës për mirëqenien e tyre
- IV. Mungesa e një punësimi, mungesa e një strehe, përdorimi i narkotikëve, emigrimi me rruge të rrezikshme e të paligjshme, jetesa në varferi për një kohë e gjatë, mungesa e afeksionit familiar si dhe niveli i ulët i vetvlerësimit.

5.11 E DREJTA PËR PJESËMARRJE

Ashtu siç u raportua nga intervistat me stafin kujdestar në institucione rezidenciale, fëmijet marrin pjesë në hartimin e planeve për lënien e përkujdesit por pjesëmarrja aktive është e ulët dhe vendimet në disa raste merren jo në përputhje më dëshirat e tyre lidhur më edukimin. Në pjesën më të madhe të rasteve ata detyrohen të ndjekin shkollën të mesme profesionale në deget që nuk i preferojnë.

Kam 20 vjet që jetoj në institucionet e përkujdesjes. Fillimisht në jetimore e pastaj këtu në konvik. U bashkova me babin, por nuk munda të jetoja më te. Gjithshka ishte e vështirë dhe e pashprese, prandaj u ktheva këtu ku jam sot – Vajzë, 20 vjeç

Unë ndoqa një shkollë profesionale që nuk e doja. Dëshiroja të ndiqja gjimnazin për të vazhduar me pas në lartën për psikologji.- (nje djale 21 vjecar që jeton në konvik, Tirane

Shkaqet e shkeljes së të drejtave

- I. Pamjaftueshmeria e shërbimeve mbështetese për të rinjte që dalin nga përkujdesi, detyron një pjesë të caregiverëve të bëjnë zgjedhje të detyruara.
- II. Kultura e mentalitetit ku fëmijët nuk shihen si pjesëtarë të vendimarrjes që lidhet me jetën e tyre.

5.12. E DREJTA PËR ARGËTIM

Gjatë qëndrimit në konvikte, të rinjte 15-24 vjeç, raportojnë se nuk ka mundësi argëtimi gjatë kohës së lirë. Kjo vështirësohet edhe nga pamundësitë financiare më të cilat përballet kjo kategori.

”Nuk ka asnjë mundësi për të organizuar aktivitete sportive në kohën e lirë. Në nuk dimë se çfarë të merremi në kohën e lirë, gjatë qëndrimit këtu. - djale 19 vjecar, që jeton në konvik, Tirane)

Shkaqet e shkeljes së të drejtave

- I. Mungesa e ambienteve, shërbimeve dhe aktiviteteve rekreative dhe argëtuese, të cilat ndikojnë në orientimin pozitiv të sjelljeve.

II. Mangësi të investimeve rekreative për të rinjtë rinjeve për ti orientuar drejt aktiviteteve të shëndetëshme gjate kohës së lirë.

6. AKTORËT KRYESORË. PËRGJEGJËSI DHE SFIDA

Aktorët	Përgjegjësitë	Sfida në përmbushjen e përgjegjësiave
Qeveria Qendrore		
1. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale Shanseve të Barabarta	<p>Përgjegjëse për hartimin e politikave, të legjislacionit, programimin e fondeve të ndihmës ekonomike, dhe të shërbimeve shoqërore, normave dhe standarteve të shërbimeve, si dhe kontrollin e zbatimit të tyre në të gjitha nivelet e strukturave, qendrore dhe vendore në sektorin publik dhe privat.</p> <p>MPÇSShB bashkëpunon me ShSSH dhe institucione të tjera të nivelit ekzekutiv për zbatimin e politikave sociale si edhe mbikqyrjen e tyre</p> <p>MPÇSSHB është institucioni përgjegjës për drejtimin, mbikqyrjen, hartimin e rregulloreve të veprimtarisë në institucionet publike, kualifikimin profesional të personelit si edhe mbikqyrjen e zbatimit të kushteve të kontratës të lidhura ndërmjet enteve shtetërore dhe jo shtetërore në lidhje me administrimin e institucioneve të përkujdesjes shoqërore.</p>	<p>MPÇSShB bashkërendon me ministri dhe institucione të tjera të nivelit qendror si pushtetin vendor. Ky bashkëpunim has ndonjëherë vështirësi.</p>
<p>Shërbimi Social Shtetëror (krijuar me VKM Nr.52, datë. 08.01.1996²⁹ ndryshuar me VKM Nr.153. Datë 25.04.2002</p>	<p>ShSSH përgjigjet për zbatimin e politikave të MPÇS në fushën e ndihmës dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Programon dhe kontrollon përdorimitn e fondeve të buxhetit të shtetit • Harton standarte të shërbimeve dhe propozon miratimin e shërbimeve të reja • Përcakton dokumentacionit për nevojshëm për aplikuesit dhe përfituesit e shërbimeve shoqërore. • Grumbullon dhe analizon informacionin mbi përdorimin e shërbimeve shoqërore edhe përfituesit 	<p>Proces i i de-intitucionalizimit qe ka filluar kerkon kohe. për pasoje nje pjese e poblemeve qe lidhen më institucionalizimin e femijeve do vazhdojne të veprojne.</p> <p>Mungesa e nje ligji mbi dalien nga përkujdesi</p> <p>Rritje e kapaciteteve në specialiste dhe ekipe qe ndjekin e asistojnë të rinjtë që dalin nga përkujdesi. Kjo</p>

²⁹ më hartimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri për Ndhmën dhe Shërbimet Shoqërore, ky vendim duhet të shfuqizohet. Por meqenëse këto akte nuk janë hartuar akoma, atëhere VKM e sipërhënuar është ende në zbatim

	<p>e shërbimeve shoqërore</p> <ul style="list-style-type: none"> Analizon nevojat për shërbime shoqërore si edhe grupet shoqërore të përjashtuara <p>ShSSH administrohet dhe drejtohet nga Këshilli Administrativ, i cili është organi më i lartë vendimmarrës. Në kryerjen e detyrave të tij, ShSSH mbështetet nga degët rajonale dhe lokale në të gjithë vendin.</p>	<p>edhe në rastet kur qeverite vendore kanë nën administrimin e tyre institucione rezidenciale.</p>
Ministritë e linjës	<p>Ministritë e linjës, janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive në fushat respektive që lidhen me çështjet e të rinjve në përkujdes apo që e kanë përkujdesin.</p>	<p>Aktualisht të rinjte që kanë lënë përkujdesin nuk janë ende grupe me prioritet në politikat dhe strategjite e tyre.</p> <p>Sistemi i mbrojtjes dhe i shërbimeve sociale është fragmentarizuar në disa ministri e drejtori, koordinimi i të cilave ka vështiresi.</p>
Avokati i Popullit, i krijuar në vitin 2000	<p>Është një institucion i pavarur i cili mbikqyr mënyrën e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Nënseksioni i të drejtave të fëmijëve, i cili sapo është themeluar, kontribuon drejtëpërsëdrejti në vlerësimin dhe matjen e efektivitetit të politikave sociale të mbrojtjes dhe zhvillimit të fëmijëve jashtë kujdesit prindëror.</p>	<p>Ka aktualisht kapacitete financiare dhe njerëzore të të kufizuara.</p>
<p>Komiteti Shqiptar i Birësimit funksionon sipas ligjit Nr.7650, dt.17.12.1992 “Per birësimet”</p> <p>KSHB është organ kolegjal më përfaqësues nga: MD, MSHP, MASH, MPCSSHB, MPJ, MR, MF, Fak. Juridik, dhe nje perfaqësues i Shoqatës së Jetimëve, të cilët përbëjnë Bordin e Komitetit Ligji i birësimeve mbështetet në Konventën e Hagës “ Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin në birësimin jashtë vendit”</p>	<p>Kompetencat e KSHB-së:</p> <ul style="list-style-type: none"> pranimin e kërkesave të paraqitura nga familiet shqiptare ose të huaj që dëshirojnë të birësojnë në Shqipëri dhe dhënia e ndihmës më qellim që të plotësojnë dosjen e tyre, hartimin e listave të të miturve që mund të birësohen brenda ose jashtë vendit. bashkëpunimin më autoritete publike dhe private të vendit dhe të huaj për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve. zgjedhjen dhe njohjen më aktet ligjore dhe procedurat përkatëse e organizmave privatë të huaj më të cilët do të bashkëpunohet për të realizuar birësimet. <p>Sipas legjilacionit në fuqi, birësimi është i përvokueshëm.</p>	<p>Me teper kujdes nga administratat e institucioneve rezidenciale lidhur më shpalljen e braktisjes.</p> <p>Jo ralle parimi ne të mire të femijes shkelet nga institucionet, duke abuzuar ose keqperdorur termin “interes i dukshem” i familiareve të femijes.</p> <p>Shume prej tyre, nuk mund të biresohen (te jetojne në nje ambient familiar) për shkak se nena, babai apo ndonje i aferm interesohet vetem për 5 minuta në vit.</p>

Pushteti vendor		
Bashkia/ Komuna	<p>Sipas ligjit “Mbi organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor” ofrimi dhe zbatimi i shërbimeve sociale në të mirë të komunitetit është pjesë e misionit të pushtetit vendor. Këshilli i Bashkisë dhe Komunës është përgjegjës për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpërndan ndihmë ekonomike familjeve dhe individëve në nevoje (përfshirë edhe jetimet me status) • Harton plane të zhvillimit të shërbimeve shoqërore komunitare bazuar në burimet, nevojat dhe prioritetet vendore • Marrjen e vendimit për personat (jetimet), familjet, llojet e shërbimeve shoqërore që do të ofrohen bazuar në: vlerësimin e nevojave të individëve si edhe mundësitë financiare për ofrimin e këtyre shërbimeve • Autorizimin e strukturave të njësisë së pushtetit vendor për kontaktimin më ofruesit e shërbimeve private të licensuara në rastet kur këto shërbime nuk ofrohen nga shërbime shoqërore publike • Miratimin e programeve të bashkëpunimit me OJF, institucionet e kultit dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, në përputhje me planet kombëtare e rajonale të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore. 	<p>Kanë burime të kufizuara financiare në ofrimin e shërbimeve.</p> <p>Kanë kapacitete jo të mjaftueshme njerëzore dhe mungesa në profesionistë që merren më çështjet e fëmijeve</p> <p>Jane ende të paafta të koordinojnë aktivitetin e aktoreve lokale që adresojnë problemet e fëmijeve jashtë kujdesit prinderor</p> <p>Statistika të pazhvilluara e për pasojë edhe mungese informacioni</p>
Këshilli I Qarkut Detyrat e keshillit të Qarkut janë percaktuar më VKM no 563, date 12.08.2005	<ul style="list-style-type: none"> • KQ, ngre komisionin e vlerësimit të nevojave dhe planifikimit të shërbimeve sociale • Bashkëpunon me MPCSSHB për vendosjen e prioriteteve (grupeve prioritare në nevoje) • Bashkëpunon me Bashkitë dhe komunat për ofrimin sa më efikas të ndihmës dhe perkujdesit shoqëror. 	Ky këshill është ende i pa strukturuar me seksione të mbrojtjes sociale dhe me specialistë
Shoqëria Civile (OJF lokale, organizata me baze komunitare).	<p>Persona juridikë privatë si edhe OJF ofrojnë shërbime të perkujdesit shoqëror. Mardhëniet juridike rregullohen nëpërmjet udhëzimit të MPCSSHB, Nr. 1321 datë 3.12.2003.</p> <p>Hartimi i këtij udhëzimi bëhet në mbështetje të nenit 102, pikës 4 të Kushtetutës si edhe nenit 34 të Ligjit Nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” si dhe pikave 4/c dhe</p>	<p>Nuk gjejne mbështetje nga strukturat publike lidhur më problemet e strehimit dhe punësimit të të rinjeve që dalin nga perkujdesi.</p> <p>Nuk mbështeten më fonde apo edhe objekte publike, mbi/ me të cilat e mund të ngrejne shërbime të reja</p>

	<p>10, të VKM Nr.307, datë 24.05.1994, “ Për Shërbimet e Përkujdesjes Shoqërore”. Sipas këtij udhëzimi, personat juridikë, privatë vendas dhe të huaj, përfshirë dhe OJF, mund të ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror pasi paisen më leje të ushtrimit të aktivitetit nga MPCSShB, sipas vendimit të një komisioni të veçantë.</p> <p>Shërbimet për fëmijë jashtë kujdesit prindëror, për të cilat nevojitet leje e veçantë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Institucione të kujdesit residencial për fëmijë më probleme sociale • Qendra të zhvillimit për fëmijë më aftësi të kufizuar • Qendra ditore të përkujdesit shoqëror për fëmijë më probleme sociale • Qendra të këshillimit psiko-social • Shërbime të kujdesit në shtëpi • Qendra të riaftësimit <p>Entet aplikuese duhet të plotësojnë kritere të përcaktuara qartë në legjislacion, të cilat janë hartuar duke marrë në konsideratë konventat nderkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë. Aktiviteti organizohet, drejtohet dhe administrohet në përputhje më kushtet e kontratës së lidhur ndërmjet entit aplikues dhe entit aprovues (MPCSShB). Aktiviteti monitorohet dhe vlerësohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, dispozitë e cila parashikohet edhe në kontratë.</p>	<p>Ndeshen me mungesa financiare përballë problemeve rritje që ju duhet të trajtojnë</p>
<p>Familja (biologjike dhe e zgjeruar) Familja foster</p>		<p>Familja ka probleme ekonomike e sociale. Shteti nuk është i aftë të zbusë problemet ekonomike e sociale që i paraprijnë abandonimit/dërgimit të fëmijëve në institucione të përkujdesjes. Rritja e jetimëve socialë është një tregues që kërkon një vëmendje të veçantë. Gjithashtu, integrimi i fëmijëve dhe të rinjve praën familjeve të tyre është një hap që kërkon mbështetje me shërbime të tjera për fuqizimin e familjes.</p>
<p>UNICEF</p>	<p>Nje program i biznesit social (YAPS) i iniciuar nga UNICEF ka realizuar punësimin e shumë të rinjeve qe kane</p>	

	<p>lene pekujdesin.</p> <p>UNICEF ka ofruar mbështetje financiare dhe profesionale për SDPS me qëllim respektimin e drejtave të fëmijeve nëpërmjet projektit të "Fuqizimit të Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në kontekstin e Reformës së Mbrojtjes Shoqërore.</p> <p>Qeveria Shqiptare dhe UNICEF kanë nënshkruar marrëveshjen mbi Programin Kombëtar të Bashkepunimit, për periudhën 2006-2010.</p>	
--	---	--

6.2 Strategjite kryesore për të rinjte pa kujdes prindëror

Plani kombëtar për fëmijet: është strategji që përcakton drejtime kryesore të zhvillimit të politikave për periudhën 2005-2010. Përfshin fushat e mbrojtjes shoqërore, kujdesin shëndetësor, arsim, zhvillim dhe pjesëmarrje .

Institucionet publike përgjegjëse të këtij plani janë: MPCSSHB, MASH, MSP, MTKRS, MD dhe MB.

Aktualisht Plani Kombëtar i Veprimeve (2005-2010) nuk parashikon veprime/ ndërhyrje mbështetëse për të rinjtë që lënë përkujdesin.

Strategjia e Mbrojtjes Sociale synon reformimin e sistemit të pagesave dhe shërbimeve shoqërore. Fushat e mbullimit janë reduktimi i varferisë, përmirësimi i transfertave në para, për familjet e varfëra (përfshirë jetimët e të rinjtë që kanë lënë përkujdesin), decentralizimin dhe de-intitucionalizimin e shërbimeve të përkujdesit për fëmijë, zgjerimin e shërbimeve me baze komunitare, pilotimin e kujdestarise foster dhe konsolidimin e shërbimeve të tipit shtëpi-familje, rritjen e numrit të operatorëve publike e të administruar nga OJF në fushën e përkujdesit.

Strategjia e Rinise është Strategji Ndërsektoriale që përcakton politikat lidhur me shëndetin dhe mbrojtjen sociale, fuqizimin ekonomik të të rinjeve, rritjen e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes, si edhe nxitjen e parimeve europiane. Institucionet publike përgjegjëse, MTKSR, MASH, MSHP, MPCSShB, MD, MRP.

6.3 Inisiativa bashkëpunimi midis aktoreve

Ka inisiativa bashkëpunimi ndërmjet

MPCSSHB më MASH për ofrimin e bursave shkollore dhe mbajtjen e të rinjeve në ambientet e konvikteve edhe pas përfundimit të mardhenieve me shkollën

UNICEF dhe MPCSHB në mbështetjen e projektit të shpërndarjes së shërbimeve sociale dhe mbështetjes së strategjise së fëmijëve.

UNFPA, MPCSHB e ShSSH, dhe lidhur me ngritjen e kapaciteteve lokale në administrimin e shërbimeve sociale komunitare

MPCSSHB dhe Qeverise vendore lidhur më decentralizimin dhe de-intitucionalizimin e shërbimeve të përkujdesit, ngritjen e shërbimeve të reja komunitare

MPCSSHB, SHSSH dhe OJF në licensimin, monitorimin e standarteve, ofrimin e mbështetjes financiare

6.4 Rriete formale dhe informale për të rinjtë

Aktualisht, nuk ekzistojne rrjete formale ose informale për të rinjte që largohen nga përkujdesi.

Ka nje tendence për ruajtjen e kontakteve informale midis të rinjve që largohen nga përkujdesi.

7. KOMENTE DHE REKOMANDIME

7.1 Çështjet kryesore

Të rinjtë shqiptare që lënë përkujdesin, përjetojnë eksperiencia nga më të veshtirat dhe vuajne diskriminim dhe dis-avantazhe të shumta.

Arsyet e disavantazheve të shumefishta, ju referohen një sërë faktoreve, por nga më të rendesishmit jane:

- 1. Modeli i përkujdesjes dhe pamjaftueshmëria e shërbimeve sociale**
- 2. Largimi nga përkujdesi në mosëe të hershme dhe mungesa e sërbimeve mbështetëse**
- 3. Mos-kordinimi i aktivitetit të strukturave të kujdesit në nivel nacional dhe lokal**
- 4. Mostrajtimi si prioritet në politikat dhe strategjite kryesore**
- 5. Stigma nga shoqëria – etiketohen si të këqinj, të pandreqshëm dhe dembel**

7.2 Shërbime të nevojshme për pavarësimin e të rinjve që lënë përkujdesin

- Ngritja e shërbimeve mëshetuese për femijet 15- 18 vjec e më pas dhe monitorimi i vazhdueshëm i të rinjeve që lënë përkujdesin.**
- Ngritje programesh, shërbimesh dhe strukturash për të rinj që lëe përkujdesin**
- Zhvillim i kurseve profesionale në perputhje me potencialet, dëshirat e të rinjeve dhe kerkesat e tregut të punës, aplikimi i formave aktive e punësimit dhe zgjerimi i programeve të biznesit social**
- Zgjatja e kohës së qëndrimit në përkujdes deri në përfundimin e shkollës së mesme ose përfundimin e arsimit të larte, kur është e mundur. Shkollimi ju jep më shumë mundësi për ëe qënë të sukseshëm në jetë. Eksperiencat e deritanishme të SOS dhe disa OJF të permëndura në këtë studim, janë të vlefshme.**
- Ngritja e qendrave ditore (shpërndarëse të shërbimeve) për të rinjtë që janë larguar nga përkujdesi (15-18 vjec)**
- Trainimi i rregullt dhe sistematik dhe ndermarrja e asistences së nevojshme psikologjike për rritjen e kapaciteteve zhvillimore të të rinjve (vetvleresim, zhvillimi psikologjik dhe emocional, etj)**
- Informimi dhe nxitja e shkollimit dhe ofrimit të mbështetjes edukative, veçatërisht asistencë për femijet që kanë probleme të zhvillimit, të cilët duhen trajtuar në qendra specifike**

Rekomandime për SOS Fshatrat e Fëmijeve dhe ofrues të tjerë shërbimi për të rinjtë pa kujdes prindëror

- **Ndërmarrja e inisiativave dhe ofrimi një ekspertize profesionale për zhvillimin e politikave të qarta dhe legjislacionit përkatës në fushën e Ins se prkujdesit dhe pas tij.**
- **Ndërtimi i Komuniteteve të reja Rinore, për të rinjtë që dalin nga përkujdesi publik.**
- **Ndërtimi i formave komunitare të shërbimit për të rinjte (klubeve rinore, qendrave psiko-sociale)**
- **Forcimi i marrdhënieve me organizata, aktorë qeveritare dhe donatorë**
- **Krijimi i mundësive për të shpërndare e replikuar Modelin e Komuniteteve Rinore**
- **Zhvillimi dhe marrja e rolit të promotorit në ngritjen e nje rrjeti OJF që punojnë në fushën e shërbimeve sociale për të rinjte që dalin nga përkujdesi**
- **Ndërmarrja e inisiativave advokuse për të luftuar stigmaten ndaj të rinjve dhe femijeve pa kujdes prinderor**

Rekomandime për aktore të tjerë

- **Marrja e përgjegjesise për permiresimin e politikës, ndertimin e një legjislacioni dhe sigurimin e buxheteve, ne mbeshtetje të të rinëve që lënë perkujdesin.**
- **Zhvillimin nga qeveria i modeleve dhe strukturave përkatëse, qe mbeshtesin të rinjtë që largohen nga përkujdesi gjate tranzicionit nga perkujdesi ne pavaresi. Format e prezantuara nga OJF janë nje shembull pozitiv.**
- **Vendosja e rregullimeve ligjore të cilat të përcaktojnë dhe rrisin detyrimin e aktoreve të ndryshëm në nivel lokal, në mbështetjen e të rinjëve jashtë përkujdesit me (a) aresim në përputhje me prirjet dhe nevojën, (b) zgjidhjen e një strehimi të qëndrueshëm dhe (c) mundësinë e një punësimi formal dhe me të ardhura të mjaftueshme.**
- **Ngritje e kapaciteteve institucionale për të monitoruar jetën e të rinjve jashtë kujdest prinderor, pas daljes nga përkujdesi**
- **Rritje e ndërgjegjesimit në të gjitha nivelet e qeverisjes për krijimine një klime mbështetese për të rinjte që kaëe lënë përkujdesin**
- **Përfshirja me fokus të veçante në Strategjine Kombetare për Femijet, të të rinjëve që kanë lënë përkujdesin (aktualisht mungon)**
- **Fuqizimi i familjes për mbrojtjen dhe perkujdesin ndaj fëmijeve me qellim parandalimin apo zgjatjen e kohes se qëndrimit të fëmijëve me prinderit, nëpërmjet mbështetjes ekonomike, psiko-sociale, shëndetsore, etj.**
- **Rritje dhe zgjerim i shërbimeve parandaluese në zonat ku edhe nevojat janë më të larta- zonat rurale dhe zonat e varfëra.**
- **Mobilizimin dhe mbeshtetje e formave komunitare që i përgjigjen nevojave lokale**
- **Ngritje kapacitetesh institucionale për monitorimin sistematik dhe folloë up të të rinjve që largohen nga përkujdesi**
- **Zbatimi i standarteve cilësore për fëmijët përgjatë kohës së përkujdesit**
- **Ngritja e kapaciteteve të stafit që punon me fëmijët jashte kujdesit prindëror, në institucionet publike**
- **Ndërtimin e klubeve/qëndrave për të rinj me pjesemarrje të përbashket nga të rinj me familje dhe qe kane lënë perkujdesin. Kjo do rrise kohezionin social ndermjet tyre, do reduktoje stigmaten ndaj care leavers dhe do rrise oportunitetet për të qënë të përfshire në jeten sociale në mënyrë të plotë**

- **Përfaqësim i të rinjve që largohen nga përkujdesi në statistikat publike dhe kryerja e rregullt e vleresimeve lidhur me ecurinë e ndërhyrjeve në legjislacion dhe**
- **Kritja e kapaciteteve dhe monitorimit për perfitimin e statusit të jetimit – konsiderimit më prioritet për punësimin dhe strehimin në perputhje më të.**
- **Realizimi i detyrimeve për dhënien e pagesave për perfituesit e statusit të jetimit**
- **Gjithashtu, duhet thënë se bashkë me ratifikimin e konventave (Karta Sociale Europiane, KDF) duhen përgatitur disa ligje e udhëzime të cilat mundësojnë zbatimin e konventave të ratifikuara.**
- **Advokatësi që financimet për shërbimet e përkujdesit të jone drejtesisht të shpërndara edhe për të rinjtë që largohen nga përkujdesi dhe që kanë dalë.**
- **Advokatësi për zbatimin e ligjit (ate egzistues aktualisht apo ligjeve të reja në e ardhmen) lidhur me procesin e tranzitimit të të rinjëve drejt pavarësisë dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse pas largimit nga përkujdesja (18 vjeç)**

BIBLIOGRAFIA

1. Mike Shtein, Research review: Young people leaving care, July 2006
2. Poverty Barometer; Ready or not, here I come, Youth aging out of child welfare system
3. Amnesty International; Albania: Adult orphan and the right to housing, November 2007
4. MPCSSHB, Strategjia Sektoriale e Shërbimeve Sociale 2007-2013, Dhjetor 2007
5. UNICEF, Raporti për zbatimin e objektivave të Strategjisë Komitare për Femijet, Maj 2008
6. SRC INSTAT, Youth and transition. Issues Confronting Albania's Key Resource
7. MPCSSHB, Përmbledhje Legjislacioni për Ndihmën Ekonomike dhe Përkujdesin Shoqëror
8. Anne Twelde, Youth leaving care- How do they fare, Briefing paper, September 2005
9. MTRKS; Strategjia Ndërsektoriale e Rinisë 2007-2013,
10. Almandina Guma, SOS Children Villages Albania; Country overview on leaving care, January 2008
11. Jim Goddard, Children leaving care in the United Kingdom: Corporate parenting and social exclusion, 2003
- 12 Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri dhe Rrjeti i të drejtave të fëmijëve në Shqipëri; Shqipëria, Raport alternativ për konventën e të drejtave të fëmijëve;
13. Ravinder Barn, Linda Andrew and Nadia Mantovani; Life after care. The experiences of young people from different ethnic groups, 2005
14. Cas O'Neil, Profile of young Australians, facts, figures and issues, 2003

15. Claire O'cain, Caludia Moedlagl, Raluca Verweijen-Slammescu, and Evelyn Winkler: Child rights situation analysis. Right based situational analysis of children without parental care and at risk of losing it. November 2006- Summary paper.
16. Dr Rea Maglajlic, Mirela Muca, UNICEF- Sistemi I Mbrojtjes se Femijeve në Shqiperi, Korrik 2007
17. Studio ligjore për femije, UNICEF, Legjislacioni shqiptar mbi Konventen e të Drejtave të Femijeve- studim krahasues, 2007
18. Qendra per Kerkime Sociale, INSTAT dhe UNICEF; Grate dhe femijet në Shqiperi, 2007

Lista e institucioneve

1	Pranvera Dizdari	SOS Fshati i Femijeve- Shqiperi	Lider rinor
2	Besnik Kolgjini	SOS Fshati i Femijeve- Shqiperi	Lider rinor
3	Perparim Demcellari	Qendra Tag, Hope for the Earth, Tirane	Drejtor
4	Lida Leskaj	Sherbimi Social Nderkombetar , Tirana	Drejtor
5	Edmira Bashmili	Terre des Homes, Tirane	Ekspert
6	Arben Zuno	Konvikt , Shkolle e mesme profesionale e Hotelerise e Turizmit	Drejtor
7	Illir Cumani	Instituti I Integritit të jetimeve, Tirane	Drejtor
8	Iva Zajmi	Ministria e Puneve të Brendeshme	Zv. Minister
9	Irena Taga	Ministria e Puneve të Brendeshme, Sektori Anti-trafik	Drejtor Sektori
10	Leonard Guni	Fëmijët e Botës, Fëmijët e Shqipërisë	Drejtor
11	Floriana Hima	UNICEF	Oficere për mbrojtjen e fëmijëve
12	Gladiola Musabelliu	Bashkia Tirane	Ekspert i Politikave Sociale
13	Esmeralda Prifti	Bashkia Tirane	Punonjes Social
14	Natassa Arapidou	Shoqata për mbeshtetjen e të rinjve /Arsis	Drejtor
15	Anila Nepravishta	Zyra e Avokatit të Popullit	Ekspert
16	Enkeleida Medha	Shtepia e femijes Zyber Hallulli,	Pergjegjese e Sektorit Social
17	Nikoleta Cepollari	Bashkia Korce	Sektori i Sherbimeve

			sociale
18	Doloreza Mila	Bashkia Bilisht, Korce	Sektori i Sherbimeve sociale
19	Berti Stratoberdha	Bashkia Korce	Drejtor ,
20	Ridvan Troshani	Bashkia Shkoder	Zv Kryetar i bashkise
21	Julia Cepi	Bashkia Shkoder	Sektori i Sherbimeve sociale
22	Fabrizio Nocchi	Maddonina Del grappa Shtëpi Familje	Drejtor
23	Diana Lekaj	Maddonina Del grappa Shtëpi Familje	Punonjese Sociale
24	Klodi Kojashi	I care, Shkoder Qendra Rinore	Drejtor
25	Adriana Neli	“Safet Spahiu” Konvikt I vajzave	Drejtor
26	Edlira Pajenga	Ndihma e Vilheimit për Shqipërinë, Elbasan	Punonjes Social
27	Slavka Cekuta	Ndihma e Vilheimit për Shqipërinë, Elbasan	Motër
28	Arjan Emini	Shtëpia e Shpresës, Elbasan	Drejtor
29	Ersila Korina	Shtëpia e Shpresës, Elbasan	Punonjes Social
30	Teit Tabaku	Tjetër Vizion, Elbasan	Drejtor

Shkurtime

MPCSSHB,	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe e Shanseve Barabarta
MASH,	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MSH,	Ministria e Shëndetit
MTRT	Ministria e Transportit dhe e Rregullimit të Territorit
MTRKS	Ministria e Turizmit, Rinisë, Kulturës dhe Sporteve
MD	Ministria e Drejtësisë
MB	Ministria e Brendshme
YAPS	Youth Albanian Parcel Service
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
INSTAT	Instituti i Statistikave
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës

- **Fëmijë/te rinj jashtë kujdesit prinderor në këte vleresim, janë femijet 0-14 vjec dhe të rinjte 14-18 vjec, të cilët nuk jetojnë më prinderit për arsye të: vdekjes së dy prindërve; heqjes dore nga kujdestaria prinderore apo abandonimi; paaftësi e perkoheshme ose e perhereshme e prindërve për tu kujdesur (semundje, vuajtje e denimit në burg); vendosje e vullnetshme (e perkoheshme) e femijeve në institucione rezidenciale; vendosje në institucione të perkujdesit nga strukturat administrative (shërbimet sociale), heqje e të drejtës prindërore (nga gjykatat); largim nga Shqipëria i femijeve të pashoqeruar nga prinderit apo trafikim. në këte studim nuk përhihen si fëmijë jashtë kujdesit prinderor, femijet të cilët nuk jetojnë më prinderit për arsye se ndjekin shkollën që janë larg vendbanimit (shkollë më konvikte), vuajnë denimin në institucione të vuajtjes së demimit.**
- **Fëmijë me aftësi të kufizuara (mendore dhe fizike) janë femijet me probleme të funksionimit mendor, prapambetje mendore, çrregulime mendore, psikosociale dhe fizike.**
- **Institucione rezidenciale të perkujdesit social janë struktura të cilat perkujdesen për femijet jashtë kujdesit prinderor. në to jeta nuk është e organizuar në baze familjeje, femijet jetojnë në grupe dhe një personell më pagese kujdeset për ta. Këto struktura mund të jete më bazë komunitare dhe strehojnë fëmijë jashtë kujdesit prinderor nga komuniteti përreth, institucione më një numër të madh femijesh ose institucione rezidenciale nacionale të cilat kujdesen për fëmijët që vijnë nga më shumë se një komunitet (bashki apo komune).**
- **Perkujdes informal është vendosja e femijeve nga prinderit e tyre nën kujdesin e të afërmeve apo miqve/shokëve ose të ofruarit në mënyrë spontane e perkujdesjes ndaj fëmijë pa prinder nga të afërmit miqte/shoket. Kujdestar mund të jete gjysherit apo të afërmit më lidhje gjaku, një mik i ngushtë i familjes.**
- **Kujdestaria/ foster care, është varianti i formalizuar/zyrtarizuar i kujdesit brenda një familjeje, ku si kujdestare janë të afërmit (me lidhje familjare apo gjaku) ose të tjerë. Kujdestaria formale vjen si rezultat i vendimeve të gjykatës apo strukturave administrative (me autoritet në dhënien e një vendimi të tillë) dhe përfshin afate kohore perkujdesjeje të shkurtra apo të gjata, të cilat gjithashtu caktohen nga gjykata apo strukturat administrative.**
- **Lënia e perkujdesit- proces përgatitjeje e të rinjve për tranzitimin e tyre nga sistemi i perkujdesit drejt pavarësisë, nga femijëria drejt të qenurit i rritur.**
- **Forma mbështetëse pas perkujdesit, – mbështetje profesionale që marrin të rinjtë pasi lënë strukturat e perkujdesjes**
- **Tranzicioni, - faza e përgatitjes e të rinjve drejt një jete të pavarur. Ajo ju jep të rinjve mundësinë për të eksploruar, reflektuar, marrjen e rreziqeve, kërkimin e identitetit, të eksperimentave dhe lirisë.**



**UNË
VLEJ**